



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.49

26 prill

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9704
datë 2.4.2007

Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të një rrjeti telematik për universitetet”

1263

Ligj nr.9709
datë 10.4.2007

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të rehabilitimit dhe ndërtimit të rrugës Fier (Levan) - Tepelenë”.

1277

Ligj nr.9711
datë 12.4.2007

Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm dhe akteve të tjera kriminale”

1290

LIGJ
Nr.9704, datë 2.4.2007

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË PËR
REALIZIMIN E NJË QENDRE SHËRBIMESH DHE TË NJË RRJETI TELEMATIK PËR
UNIVERSITETET”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të një rrjeti telematik për universitetet”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5265, datë 17.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË ITALISË PËR “REALIZIMIN E NJË QENDRE SHËRBIMESH DHE TË NJË
RRJETI TELEMATIK PËR UNIVERSITETET”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në vijim e emërtuar MASH, nga njëra anë, dhe

Qeveria e Republikës Italiane, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme-Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim, në vijim e emërtuar MPJ-DPBZH, nga ana tjetër, së bashku të emëtuara “Palët”;

duke parashtruar që në kuadrin e Komisionit të përbashkët Itali-Shqipëri është rënë dakord nga protokoll i bashkëpunimit për zhvillim, i nënshkruar në Tiranë, më 9 prill 2002, lidhur me ndërhyrjet në mbështetje të sistemit arsimor, me një vëmendje të veçantë ndaj arsimit universitar dhe përforcimit të sistemit arsimor të detyrueshëm dhe të mesëm në vend;

duke marrë në konsideratë rëndësinë që strategjia e reformës ekonomike dhe e zhvillimit të vendit i jep përmirësimit të cilësisë dhe të efektshmërisë së sektorit të arsimit, siç tregohet në planin e investimeve publike 2000-2003 të Shqipërisë;

duke marrë në konsideratë vullnetin e Palëve për të realizuar një projekt të emërtuar “Realizimi i një Qendre Shërbimesh dhe i një Rrjeti Telematik për universitetet”, me një kosto totale prej 4 000 000,00 (katër milionë) eurosh, në ngarkim të MPJ-DPBZH, për të cilin Palët kanë nënshkruar një “Aide-de-Memoire”, në datën 5.5.2003,

për sa u parashtrua më lart të dyja Palët bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Qëllimi, Palët dhe përkufizimet e Marrëveshjes

1.1 Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të rregullojë angazhimet e ndërsjella të Palëve për një zbatim korrekt të projektit, duke iu referuar në mënyrë të veçantë modaliteteve të realizimit të veprave, blerjes së të mirave dhe të shërbimeve, si dhe modaliteteve që kanë të bëjnë me administrimin, caktimin dhe dhënien e fondeve.

1.2 Kjo Marrëveshje përbëhet nga 12 nene, si dhe nga dokumenti teknik i bashkëngjitur.

1.3 Fjalët dhe shkurtesat e përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet e mëposhtme:

Projekti: Nisma për realizimin e një Qendre Shërbimesh dhe të një Rrjeti Telematik për universitetet;

ANA: Academic Networking of Albania;

Amb-ZTV: Ambasada e Italisë-Zyra Teknike Vendore e Bashkëpunimit në Tiranë;

KA: Këshilli Administrativ i Qendrës së Shërbimeve për Universitetet;

KRUI: Konferenca e Rektorëve Italianë;

QRA: Qeveria e Republikës së Shqipërisë;

RRUKI: Rrjeti i Universitetit dhe i Kërkimeve Shkencore Italiane;

ICT: Informatin and Communication Technology;

MPJ-DPBZH: Ministria e Punëve të Jashtme-Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim;

MASH: Ministria e Arsimit dhe e Shkencës Shqiptare;

MF: Ministria e Financave Shqiptare;

PIU: Project Implementation Unit;

RTASH: Rrjeti Telematik Akademik Shqiptar;

ZTQ: Zyra Teknike Qendrore e Drejtorisë së Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim.

Neni 2

Objektivat e projektit

2.1 Objektivat e përgjithshme të projektit janë:

2.1.1 Përshtatja e sistemit arsimor universitar dhe atij kërkimor në Shqipëri me nivelet e vendeve të Bashkimit Europian.

2.1.2 Objektivat e Paktit të Stabilitetit për zhvillim social-ekonomik dhe kulturor të vendit dhe për integrimin e tij rajonal dhe europian, në kuadrin e direktivave të Konferencave të Bolonjës, Pragës dhe Berlinit.

2.2.3 Rritja e pjesëmarrjes së profesorëve/punonjësve shkencorë shqiptarë në aktivitetet e kërkimit dhe të zhvillimit të drejtuar nga komuniteti shkencor dhe arsimor ndërkombëtar, dhe në mënyrë të veçantë nga ai italian, falë disponueshmërisë së një Rrjeti Telematik të lidhur me sistemin italian RRUKSHI.

2.2 Për të arritur objektivat e përgjithshme të përmendura më sipër, projekti synon të arrijë objektivin specifik të mëposhtëm:

Përmirësimin dhe fuqizimin e universiteteve shqiptare në funksionin e tyre si përhapëse të dijeve të një niveli të lartë dhe si zbatuese dhe nxitëse të veprimtarisë kërkimore.

Neni 3

Rezultatet e projektit

3.1 Në përputhje me objektivat e paraqitura në nenin 2, projekti ka si synim që të arrijë rezultatet e mëposhtme (rezultatet janë përshkruar në mënyrë të hollësishme në dokumentin teknik të bashkëngjitur);

3.1.1 Ngritjen e një Qendre Shërbimesh për të trija Universitetet e Tiranës.

3.1.2 Zgjerimin e mëtejshëm të Qendrës së Shërbimeve për të mbuluar nevojat e të gjitha universiteteve të tjera shqiptare.

3.1.3 Krijimin e një Rrjeti Telematik Akademik Kombëtar, të lidhur me RTASH-in (Rrjetin Telematik Akademik Shqiptar), për të lidhur Qendrën e Shërbimeve, të njëmbëdhjetë universitetet, si

dhe institutet e tjera të kërkimit dhe të formimit universitar.

Neni 4

Institucione të përfshira në projekt

4.1 Institucionet e përfshira në realizimin e projektit janë si më poshtë:

4.1.1 Për Palën Italiane:

4.1.1.1 MPJ-DPBZH, e cila do të ofrojë burimet financiare dhe asistencën teknike, sipas modaliteteve të parashikuara nga kjo Marrëveshje.

4.1.1.2 Ambasada/ZTV, e cila duke kryer drejtimin e përgjithshëm të aktiviteteve të projektit, do të sigurojë kontaktet e nevojshme me Palën Shqiptare të projektit.

4.1.2 Për Palën Shqiptare:

4.1.2.1 MF, e cila do të kujdeset për t'i transferuar MASH-it burimet financiare të dhëna nga MPJ-DPBZH për realizimin e projektit, si edhe ato të nevojshme për të mbuluar kostot në kompetencë të Palës Shqiptare.

4.1.2.2 MASH, e cila do të kujdeset në mënyrë të veçantë për zbatimin e projektit, duke vënë në dispozicion strukturat dhe personelin shqiptar, duke marrë masat e nevojshme administrative, duke zhvilluar tenderat për blerjen e të mirave dhe të shërbimeve dhe duke administruar kontratat përkatëse.

Neni 5

Detyrimet e Qeverisë Italiane

5.1 MPJ-DPBZH merr përsipër të kontribuojë në realizimin e projektit me një financim falas të një shume prej 4 000 000,00 (katër milionë/00) eurosh. Ky financim do të ndahet si më poshtë vijon:

- Një shumë prej 3 600 000,00 (tre milionë e gjashtëqind mijë/00) eurosh do të vihet në dispozicion të QRSH-së në tri transhe, shuma e të cilave është përcaktuar në nenin 7 të mëposhtëm për pagesën e kostove të projektit në Shqipëri, të përshkruara me hollësi në dokumentin teknik të bashkëngjitur;

- Një shumë prej 220 000,00 (dyqind e njëzet mijë/00) eurosh do të përdoret drejtpërdrejt nga MPJ-DPBZH për aktivitetet e asistencës teknike, si edhe të monitorimit dhe vlerësimit të Palës Italiane;

- Një shumë prej 180 000,00 (njëqind e tetëdhjetë mijë/00) eurosh do të vihet në dispozicion të Ambasadës/ZTV për aktivitete të asistencës teknike dhe të lidhjes me Palën Shqiptare, prej së cilës 140 000,00 (njëqind e dyzet mijë/00) euro që kanë të bëjnë me kontratat me personelin dhe me konsulentët e punësuar në vend.

Neni 6

Detyrimet e Qeverisë Shqiptare

6.1 MF do t'i japë udhëzime Bankës që do të caktojë për hapjen e një llogarie rrjedhëse të veçantë, në emër të QRSH-së dhe të emërtuar "Projekti i bashkëpunimit Itali-Shqipëri për universitetet";

6.2 MASH-i merr përsipër se do të bëjë gjithë çfarë ka në kompetencën e vet për realizimin e mirë të projektit dhe në mënyrë të veçantë:

6.2.1 të marrë masat administrative dhe, në qoftë se do të jetë e nevojshme edhe masat legjislative, që do të bëjnë të mundur krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve për universitetet;

6.2.2 t'ia besojë administrimin e Rrjetit Telematik Qendrës së Shërbimeve;

6.2.3 t'ia paraqesë MPJ-DPBZH, për miratim, statutin e Qendrës, si edhe planin e fillimit të projektit dhe planet operative gjashtëmujore të Qendrës, të cilat lidhen me periudhën e realizimit të projektit;

6.2.4 të pajisë Qendrën me personel të kualifikuar, të punësuar nëpërmjet konkurseve të rregullta publike;

6.2.5 të përzgjedhë zbatuesin e aktiviteteve të asistencës teknike dhe të formimit për Qendrën dhe realizuesin e Rrjetit Telematik, nëpërmjet tenderave të zhvilluara, sipas procedurave të Komisionit European për ndihmë ndaj vendeve të treta, të treguara më poshtë në nenin 8, pika 8.2;

6.2.6 të vërë në dispozicion të Qendrës ambiente të përshtatshme për zhvillimin e funksioneve të saj;

6.2.7 të përballojë barrën e detyrimeve, të përshkruara në dokumentin teknik të bashkëngjitur dhe të pambuluar nga financimi italian, duke përfshirë çdo taksë dhe detyrim doganor në Shqipëri; në mënyrë të veçantë, Qeveria Shqiptare merr përsipër që të mbulojë deficitet e mundshme të bilancit të Qendrës;

6.2.8 t'u lejojë MPJ-DPBZH dhe Ambasadës/ZTV të kryejnë veprimtarinë e kontrollit, të monitorimit dhe të vlerësimit, duke lejuar, ndër të tjera, aksesin në vendet e projektit dhe në dokumentacionin teknik përkatës. Për këtë qëllim, ky dokumentacion do të ruhet për një periudhë, së paku pesë vjet nga dita e dërgimit të raportit të fundit, për të cilin bëhet fjalë në nenin 7 të mëposhtëm, pika 7.3.4;

6.2.9 të ripërtërijë llogarinë rrjedhëse të veçantë me shumat që u korrespondojnë shpenzimeve që MPJ-DPBZH do t'i duhet të përballojë, në fazën e verifikimit të raporteve, shpenzime të cilat nuk i ngarkohen projektit.

Neni 7

Modalitetet e dhënies së financimit

7.1 Financimi i projektit, me një shumë maksimale prej 3 600 000,00 (tre milionë e gjashtëqind mijë/00) eurosh, do t'i vihet në dispozicion QRSH-së nga ana e MPJ-DPBZH-së dhe do t'i njoftohet MF-së me një komunikatë zyrtare, përmes Ambasadës/ZTV, pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

7.2 Financimi do të depozitohet në tri transhe të njëpasnjëshme në llogarinë rrjedhëse të veçantë, për të cilën bëhet fjalë në pikën 6.1. MF-ja Shqiptare do të caktojë MASH-in si entin përgjegjës për administrimin e fondeve të projektit. Llogaria do të vihet në lëvizje nga MASH-i për financimin e aktiviteteve të parashikuara në dokumentin teknik bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje.

7.3 Shuma e financimit do të derdhet nga MPJ-DPBZH, sipas modaliteteve të mëposhtme:

7.3.1 Transhi i parë prej 400 000,00 (katërqind mijë/00) eurosh, do të dhurohet nga MPJ-DPBZH pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe pas datës së:

7.3.1.1 marrjes së datës dhe të dhënave të llogarisë rrjedhëse të veçantë, të hapur për projektin;

7.3.1.2 marrjes së një njoftimi për krijimin e PIU-t në MASH;

7.3.1.3 marrjes së një raporti në lidhje me përzgjedhjen e një shoqërie auditimi me një besueshmëri të provuar dhe të draftit përkatës të kontratës;

7.3.1.4 dhënies së lejes për nënshkrimin e kontratës së sipërpërmendur nga ana e MPJ-DPBZH-së.

7.3.2 Transhi i dytë prej 2 300 000,00 (dy milionë e treqind mijë/00) eurosh do të jepet nga MPJ-DPBZH pas datës së:

7.3.2.1 marrjes së raportit të shpenzimeve të bëra dhe të angazhimeve financiare të kryera me financimin italian, i vërtetuar nga shoqëria e auditimit, që të vërtetojë se të paktën 50% e shumës së transhit të parë është shpenzuar, si edhe miratimin e tij nga ana e DPBZH-së;

7.3.2.2 marrjes së një relacioni teknik përshkrues të veprimtarive të realizuara që, në mënyrë të veçantë, të vërtetojë: i) krijimin e Këshillit Administrativ; ii) punësimin e personelit të Qendrës; iii) përzgjedhjen, nëpërmjet tenderit të zhvilluar, sipas procedurave të treguara më poshtë në nenin 8, të zbatuesit të asistencës teknike dhe trajnimit të personelit të Qendrës dhe të realizuesit të Rrjetit Telematik;

7.3.2.3 marrjes së teksteve të kontratave që synohet të nënshkruhen dhe miratimit nga ana e DPBZH-së për nënshkrimin e përmendur më lart;

7.3.2.4 marrjes së statutit të Qendrës së Shërbimeve, të përgatitur nga MASH-i, dhe miratimit, nga ana e MPJ-DPBZH-së, të statutit të lartpërmendur.

7.3.3 Transhi i tretë prej 900 000,00 (nëntëqind mijë/00) eurosh do të dhurohet nga MPJ-DPBZH-së pas datës së:

7.3.3.1 marrjes së raportit të shpenzimeve të bëra dhe të angazhimeve financiare të kryera me

financimin italian, i vërtetuar nga shoqëria e auditimit, që të vërtetojë se të paktën 70% e shumës së trashit të parë e të dytë është shpenzuar, si edhe miratimin e tij nga ana e DPBZH-së;

7.3.3.2 marrjes së një relacioni teknik, i cili të përshkruajë veprimtaritë e realizuara dhe në mënyrë të veçantë, të vërtetojë domosdoshmërinë e shtrirjes edhe në vitin e tretë të aktivitetit të kontratës së asistencës teknike dhe të trajnimit.

7.3.4 Në përfundim të veprimtarive të projektit, MASH-i do t'i paraqesë MPJ-DPBZH-së një raport përfundimtar për përdorimin e fondeve të dhëna, i vërtetuar nga shoqëria e auditimit, si edhe një raport përfundimtar për aktivitetet. Shumat e papërdorura dhe të pajustificuara do të duhen t'i kthehen MPJ-DPBZH-së.

Neni 8

Përdorimi i fondeve

8.1 Burimet financiare të mundësuar nga kjo Marrëveshje do të duhet të përdoren për arritjen e objektivave dhe rezultateve të paraqitura në nenet 2 dhe 3, si dhe për zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në dokumentin teknik të bashkëngjitur. Financimi i lartpërmendur nuk do të mund të përdoret për pagesën e:

- sendeve të luksit ose atyre të tepërta (për shembull: parfume, artikuj kozmetikë, objekte arti, pije alkoolike, artikuj sportivë etj.);
- të mirave, shërbimeve dhe punëve botore të lidhura drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt me aktivitete ushtarake ose të policisë;
- taksave dhe detyrimeve doganore;
- furnizimeve të përfituesve për borxhe të pashlyera dhe për humbje të ardhshme;
- interesave të kontraktuara nga përfituesit ndaj palëve të treta.

QRSH-ja do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar një administrim të efektshëm të fondeve dhe për të parandaluar çdo abuzim dhe përdorim të paligjshëm të tyre.

8.2 Përcaktimi i zbatuesve të aktiviteteve të projektit do të kryhet në vend nëpërmjet tenderave të hapur, të rezervuar për shoqëritë italiane. Për caktimin e kontratave të nevojshme për realizimin e projektit do të zbatohen procedurat e parashikuara në "*Practical Guide to contract procedures for EC external actions*", të datës 1.2.2006, si dhe ndryshimet dhe plotësimet e mëtejshme, në përshtatje me veçoritë specifike të grantit italian, si edhe nga sa është saktësuar në këtë Marrëveshje.

8.3 Çmimi i përgjithshëm i kontratës së asistencës teknike të Qendrës së Shërbimeve duhet të ketë lidhje më të mira dhe shërbime me prejardhje/kombësi italiane. Çmimi i përgjithshëm i kontratës së asistencës teknike të Rrjetit Telematik duhet të ketë lidhje më të mira dhe shërbime me prejardhje/kombësi italiane për një kuotë jo më të ulët se 40%.

8.4 Kontratat e nënshkruara me zbatuesin e asistencës teknike në Qendër dhe me realizuesin e Rrjetit Telematik, duhet të parashikojnë një paradhënie fillestare prej 50% të shumës përkatëse të përgjithshme, mbas lëshimit me garanci dorëzanie, e rikthyeshme si pjesë e kuotës së pagesave;

8.5 Interesat e mundshme të maturuara do të duhet të raportohen dhe do të mund të përdoren për të financuar aktivitetet e projektit pas marrëveshjes mes Palëve.

8.6 Si dokumentacioni i tenderit, ashtu edhe nënshkrimi i kontratës do të duhet t'i nënshtrohen paraprakisht DPBZH-së për miratimin përkatës.

Neni 9

Mosmarrëveshjet

Në rast se do të lindin mosmarrëveshje gjatë realizimit të projektit, të cilat kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, ato do të duhet të diskutohen dhe të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 10

Pezullimi dhe zgjidhja e kontratës

10.1 MPJ-DPBZH rezervon të drejtën që të pezullojë dhënien e financimit në rastet e mëposhtme:

- 10.1.1 Për shkelje të rënda nga ana e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përbëjnë shkelje të rënda:
- 10.1.1.1 ekzistenca e vonesave të zgjatura dhe të pamotivuara në përdorimin e financimit italian, të tilla që të vënë në rrezik zhvillimin e aktiviteteve të parashikuara;
- 10.1.1.2 përdorimi i financimit italian për aktivitete të ndryshme nga ato që janë përcaktuar nga projekti;
- 10.1.1.3 ekzistenca e parregullsive të rënda në administrimin e financimit italian, gjithsesi të verifikuara;
- 10.1.2 në rast se ndodhin fakte që e bëjnë të pamundur realizimin e projektit, siç parashikohet në nenin 11 vijues.
- 10.2 MPJ-DPBZH rezervon të drejtën që të heqë dorë nga Marrëveshja në rastet e mëposhtme:
- 10.2.1 mosrealizim të veprimtarive të parashikuara në projekt;
- 10.2.2 pengesë e zgjatur për shkak forcash madhore.
- 10.3 Në të dyja rastet e përmendura më sipër, MPJ-DPBZH mund të vendosë në mënyrë të njëanshme përfundimin e Marrëveshjes, duke e njoftuar MASH-in nëpërmjet një note verbale, të paktën tre muaj më parë.

Neni 11

Pengesa për shkaqe forcash madhore

Në rast pengese të realizimit të projektit, si pasojë e shkaqeve të forcave madhore (konflikt i armatosur, fatkeqësi natyrore ose prishje e rendit publik), do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

11.1.1 Në rastet kur kohëzgjatja e pengesës do të jetë më e vogël se gjashtë muaj, projekti pezullohet dhe fondet e papërdorura do të mbahen deri sa të marrë fund pengesa dhe të mbërrijë autorizimi i MPJ-DPBZH-së për rifillimin e aktiviteteve, të cilat do të duhen të rishikohen dhe të miratohen nga Palët përpara se të procedohet me shpenzimet.

11.1.2 Në rast se kohëzgjatja e pengesës do të jetë më e madhe se gjashtë muaj, Palët duhet të bien dakord mbi vazhdimin e projektit dhe të vendosin mbi linjën e veprimeve. Në rast pamundësie për të vazhduar aktivitetet, Palët kanë për detyrë që të vendosin destinacionin e fondeve të mbetura dhe të papërdorura.

11.1.3 Veprimtaritë e projekteve të parrezikuara nga pengesa mund të vazhdojnë deri në plotësimin e tyre dhe fondet e destinuar për to mbeten të disponueshme.

Neni 12

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe ndryshimet

12.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së notës së dytë verbale, me anën e së cilës Palët Kontraktuese do t'i komunikojnë njëra-tjetrës kryerjen e procedurave përkatëse të brendshme të parashikuara në rast nevojë.

12.2 Kjo Marrëveshje ka një kohëzgjatje prej tre vjetësh, duke filluar nga data e hyrjes së saj në fuqi. Në rast se në përfundimin e afatit të tre vjetëve aktivitetet e projektit nuk janë plotësuar, Palët do të mund të bien dakord për një shtyrje të afateve të vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje, brenda caceve të përdorimit të shumave të mbetura, të parashikuara në të nëpërmjet ndryshimeve.

12.3 Palët mund të bien dakord në çdo kohë për të bërë ndryshime në këtë Marrëveshje dhe në dokumentin teknik përkatës të bashkëngjitur, duke i zyrtarizuar këto ndryshime nëpërmjet shkëmbimit të notave verbale. Këto ndryshime do të hyjnë në fuqi sipas modaliteteve të parashikuara në rast nevojë.

Si vërtetim për gjithë sa më sipër, të nënshkruarit përfaqësues kanë firmosur këtë Marrëveshje, të autorizuar siç duhet nga qeveritë përkatëse.

Bërë në Tiranë në 21.12.2007 mënë dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqip dhe italisht. Të dyja tekstet janë të barasvlefshme.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË ITALISË
AMBASADORI I ITALISË NË SHQIPËRI

REALIZIMI I NJË QENDRE SHËRBIMESH DHE I NJË RRJETI TELEMATIK
PËR UNIVERSITETET
DOKUMENTI TEKNIK I BASHKËNGJITUR ME MARRËVESHJEN NDËRQEVERITARE

1. Objektivat e përgjithshme të projektit

a) Barazimi i sistemit të arsimit të lartë dhe i kërkimit shkencor në Shqipëri me nivelet e vendeve të Bashkimit Europian.

b) Objektivat e Paktit të Stabilitetit për zhvillimin shoqëror-ekonomik dhe kulturor të vendit dhe për integrimin e tij rajonal dhe europian, në kuadrin e linjave të projektit të Konferencave të Bolonjës, Pragës dhe Berlinit.

c) Shtimi i pjesëmarrjes së profesorëve/kërkuesve shkencorë shqiptarë në veprimtaritë e kërkimit dhe të zhvillimit të drejtuara nga komuniteti shkencor dhe edukativ ndërkombëtar, në mënyrë të veçantë nga ai italian, falë disponueshmërisë së një Rrjeti Telematik të lidhur me sistemin italian GARR (Rrjeti i universiteteve dhe i kërkimeve shkencore italiane).

2. Objektivi specifik

Përmirësimi dhe fuqizimi i universiteteve shqiptare në funksionet e tyre si përhapëse të arsimit të nivelit të lartë dhe si zbatuese dhe nxitëse të veprimtarive kërkimore shkencore.

3. Rezultatet e pritshme

Rezultatet kryesore të parashikuara janë:

Rezultati 1: Qendër ndëruniversitare për nxitjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor, e krijuar dhe vepruese:

- Statuti, i miratuar
- Organet e administrimit, të krijuara dhe operative;
- Rregullat e funksionimit të brendshëm, të hartuara dhe të miratuara;
- Selia e Qendrës, e rehabilituar dhe e mobiluar;
- Personeli drejtues, teknik dhe administrativ, i përzgjedhur dhe i trajnuar.

Rezultati 2: Kurse specializimi pasuniversitare, të ngritura dhe të hapura:

- 8 kurse master-i, të ngritura;
- Rreth 15 doktoratura të realizuara në Itali;
- Mbi 100 docentë, të informuar nëpërmjet didaktikës interaktive *on line*;
- Rreth 20 të diplomuar, të trajnuar nëpërmjet kurseve të formimit profesional të lartë të realizuar në Shqipëri (sipas modelit të arsimit dhe formimit teknik të lartë-IFTS);
- Laboratorë në mbështetje të kurseve master dhe të arsimit dhe të formimit teknik të lartë-IFTS, të pajisur me aparatura didaktike dhe shkencore.

Rezultati 3: Akreditimi i kurseve universitare, në mënyrë që të krijohet mundësia e zbatimit të standardeve europiane të vlerësimit të cilësisë së ofertës, të ngritura:

- Operatorë (të paktën 4) për akreditimin e arsimit universitar, në mënyrë që të krijohet mundësia e zbatimit të normativave të reja dhe të standardeve të vlerësimit;
- Standarde cilësie dhe procedura zbatuese të përditësuara në nivelet europiane dhe të përshtatura me kushtet e universiteteve shqiptare;
- Të paktën 20 kurse diplome të vlerësuara në zbatim të normativave dhe të kriterëve të përditësuara të cilësisë.

Rezultati 4: Procesi i reformës së arsimit të lartë, në lidhje, në mënyrë të veçantë, me strukturën kurrikulare, me kërkimin shkencor, me autonominë universitare, me vlerësimin e cilësisë, i nisur:

- Studimi i gjendjes së arsimit të lartë dhe i kërkimit shkencor në Shqipëri, i realizuar;
- Ekspertë shqiptarë të informuar mirë mbi sistemin universitar italian dhe europian;
- Propozime reformash/përditësime, të hartuara dhe të paraqitura në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës Shqiptare (MASH).

Rezultati 5: Procesi i përmirësimit të administrimit të 11 institucioneve shqiptare të arsimit të lartë, i nisur:

- Rreth 120 operatorë dhe administrues të universiteteve, në mënyrë që të krijohet mundësia e

zbatimit të procedurave të reja dhe programe kompjuterike (*software*), të futur nëpërmjet projektit;

- Metoda të reja administrimi, procedura dhe programe kompjuterike, të përpunuara dhe të zbatuara.

Rezultati 6: Aftësitë e instituteve të arsimit të lartë për të marrë pjesë në shpallje tenderash ndërkombëtarë dhe europianë dhe për të ofruar shërbime në treg, të përforcuara:

- Informacion mbi karakteristikat dhe mbi evolucionin e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor, në mënyrë të veçantë, në lidhje me krijimin e hapësirës universitare europiane, në mënyrë të vazhdueshme në dispozicion të universiteteve, e përditësuar;

- Aftësia e universiteteve për të kryer kërkime shkencore, për të përzgjedhur, për të interpretuar dhe për të marrë pjesë në shpallje tenderash ndërkombëtarë dhe europianë, si dhe për të marrë pjesë në mënyrë aktive në marrëdhëniet përkatëse të partneritetit, e krijuar;

- Bankë të dhënash mbi burimet e disponueshme pranë secilit universitet, e krijuar;

- Të paktën një katalog me shërbimet e ofruara për secilin universitet, i botuar;

- Të paktën një fushatë reklamuese pranë subjekteve private dhe publike, e realizuar;

- Një sportel informacioni mbi politikën europiane, i aktivizuar;

- Të paktën një specialist për secilin universitet, i formuar për kërkimin e informacioneve dhe për interpretimin e shpalljeve të tenderave ndërkombëtarë.

Rezultati 7: Rrjet Telematik Akademik Kombëtar për të lidhur ndërmjet tyre njëmbëdhjetë universitetet, pjesën më të madhe të instituteve kërkimore, Akademinë e Shkencës dhe Qendrën Ndëruniversitare, i realizuar:

- Infrastruktura e rrjetit, e instaluar dhe operative;

- Universitete dhe institute që të kenë mundësinë e përfitimit të shërbimeve telematike me nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të mundësisë së lidhjes me internetin;

- Hyrje në Metropolitan Area Network (MAN) për të përfituar shërbimet vendore, e realizuar.

Rezultati 8: Personel teknik vendas i formuar, me kompetenca, për administrimin e rrjetit dhe për zbatimin e programeve të reja kompjuterike:

- Operatorë në gjendje për të administruar rrjetin dhe programet kompjuterike administrative, të formuar;

- Pajisje teknologjike për administrimin e kurseve *on line*, e strukturuar dhe operative;

- Programe kompjuterike administrative të disponueshme, të paktën në zonat strategjike të drejtimit administrativ dhe juridik të plotësuar të personelit universitar, të drejtimit administrativ të studentëve, të administrimit të kontabilitetit;

- Platformë për formimin në distancë, e projektuar dhe operative.

4. Veprimtaritë

Për të arritur rezultatet e pritshme do të zhvillohen veprimtaritë kryesore të mëtejshme:

4.1 Veprimtari që kanë lidhje me rezultatin 1 (Qendra Ndëruniversitare):

4.1.1 Hartimi i statutit të Qendrës dhe miratimi i tij nga ana e Këshillit të Ministrave;

4.1.2 Krijimi në Qendër i Komitetit të Programimit dhe të Drejtimit;

4.1.3 Përcaktimi i procedurave të rregullave të funksionimit të Qendrës;

4.1.4 Realizimi i strukturave në të cilat do të vendoset Qendra Ndëruniversitare;

4.1.5 Instalimi dhe kolaudimi i mjeteve të punës;

4.1.6 Përzgjedhja e operatorëve dhe krijimi i organikës.

4.2 Veprimtari që kanë lidhje me rezultatin 2 (Kurse specializimi pasuniversitare)

4.2.1 Kërkim mbi sistemet e formimit pasuniversitar në kuadrin europian dhe ballkanik;

4.2.2 Studim mbi nevojat formuese në lidhje me kërkesën për teknikë, specialistë të nivelit të lartë (kurse pas diplomimit);

4.2.3 Studim mbi nevojat formuese në lidhje me kërkesën për formim pasuniversitar (mastera dhe doktoratura);

4.2.4 Përcaktimi i kriterëve dhe përzgjedhja e kandidatëve pjesëmarrës në doktoratura, në mastera, në kurse specializimi pas diplomimit (sipas modelit italian të arsimit dhe të formimit teknik të lartë-IFTS);

4.2.5 Projektimi dhe realizimi i kurseve të formimit profesional të lartë pas diplomimit (sipas modelit italian të arsimit dhe të formimit teknik të lartë-IFTS), të cilat u drejtohen rreth 20 studentëve;

4.2.6 Projektimi dhe realizimi i tetë kurseve master, të cilat u drejtohen rreth 200 të diplomuarve;

- 4.2.7 Projektimi dhe realizimi i rreth 15 doktoraturave;
- 4.2.8 Projektimi dhe realizimi i kursit *on line* mbi metodologjinë mësimore (me pajisje dhe programe kompjuterike), i cili u drejtohet rreth 100 docentëve;
- 4.2.9 Organizimi i stafit teknik dhe didaktik dhe për realizimin e kurseve *on line*;
- 4.2.10 Marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës shqiptare për njohjen e titullit të studimit, të cilat kanë të bëjnë me veprimtaritë e zhvilluara në Shqipëri dhe në Itali;
- 4.2.11 Identifikimi, furnizimi dhe kolaudimi i sasive të kufizuara të pajisjeve të nevojshme për realizimin e kurseve.
- 4.3 Veprimtari që kanë lidhje me rezultatin 3 (Akreditimi):
 - 4.3.1 Kërkimi i “praktikave të mira” në nivel italian dhe europian për vlerësimin e cilësisë së arsimit të lartë;
 - 4.3.2 Hartimi i standardeve dhe i procedurave të vlerësimit të cilësisë së sistemit universitar;
 - 4.3.3 Vlerësimi i të paktën 20 kurseve të diplomës universitare mbi bazën e zbatimit të normativave dhe të kriterëve të përditësuar të cilësisë;
 - 4.3.4 Trajnimi i të paktën katër operatorëve për akreditimin e sistemit universitar nëpërmjet kurseve në vend, bursave të studimit në Itali dhe ndihmesës në Shqipëri nga ana e ekspertëve italianë.
- 4.4. Veprimtari që kanë lidhje me rezultatin 4 (reforma e arsimit të lartë).
 - 4.4.1 Studimi dhe identifikimi i tematikave të sektorëve në të cilët duhet ndërhyrë me përparësi;
 - 4.4.2 Hartimi i planit të punës dhe miratimi i tij nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës Shqiptare (MASH);
 - 4.4.3 Seminare në Shqipëri, takime me universitetet, vizita në Itali për mbledhjen e të dhënave dhe për përditësimin e ekspertëve shqiptarë;
 - 4.4.4 Hartimi i propozimeve të reformës dhe të ndryshimit të përditësimit, me bashkëpunimin e ekspertëve italianë.
- 4.5. Veprimtari që kanë lidhje me rezultatin 5 (Përmirësimi i administrimit):
 - 4.5.1 Studim paraprak që ka lidhje me gjendjen e procedurave ekzistuese, me analizën e pikave të dobëta, të forta, të elementeve me rrezik dhe të mundësive;
 - 4.5.2 Analizë e nevojave për trajnim në sektorin e drejtimit administrativ;
 - 4.5.3 Hartimi i procedurave të reja dhe i programeve kompjuterike;
 - 4.5.4 Projektimi dhe realizimi i veprimtarisë së trajnimit, i cili u drejtohet rreth 120 operatorëve dhe drejtuesve të administratës së universiteteve, nëpërmjet një kursi dymujor në Shqipëri dhe bursave të studimit në Itali;
 - 4.5.5 Zbatimi i programeve kompjuterike dhe i procedurave të reja me asistencën teknike nga ana e ekspertëve italianë.
- 4.6. Veprimtari që kanë lidhje me rezultatin 6 (Aftësitë e instituteve të arsimit të lartë për të marrë pjesë në shpallje tenderash ndërkombëtarë dhe europianë dhe për të ofruar shërbime në treg):
 - 4.6.1 Studime paraprake mbi gjendjen e shërbimeve të brendshme të universiteteve dhe mbi aftësitë e marrëdhënieve me tregun dhe me universitetet e tjera europiane;
 - 4.6.2 Studim mbi kanalet dhe mbi burimet më të mëdha informuese, të cilat kanë lidhje me gjendjen dhe me evolucionin e sistemit universitar të kërkimit të disponueshme në internet;
 - 4.6.3 Projektimi dhe realizimi i një banke informatike të të dhënave dhe nxjerrja në qarkullim e një buletini informatik ndëruniversitar lajmesh;
 - 4.6.4 Projektimi dhe realizimi i katalogut të shërbimeve të ofruara që, secili universitet mundet të ofrojë jashtë tij;
 - 4.6.5 Projektimi dhe realizimi i një kursi formimi për specialistët e lidhjeve të jashtme dhe të përzgjedhjes së informacioneve *on line*;
 - 4.6.6 Strukturimi i aftësive për të marrë pjesë në tendera europianë dhe për përpunimin e projekteve;
 - 4.6.7 Organizimi i tabelës informuese të përhershme që ka lidhje me veprimtaritë e Komisionit Europian.
- 4.7. Veprimtari që kanë lidhje me rezultatin 7 (Rrjeti Telematik Akademik Kombëtar):
 - 4.7.1 Zbulimi i ekzistueses, nën aspektin e disponueshmërisë së hësë dhe të rrjetit në universitetet e veçanta dhe në qendrat kërkimore shkencore;

- 4.7.2 Zbulimi i ofertës tregtare qoftë për linja, qoftë për mundësi lidhjeje me internetin;
- 4.7.3 Identifikimi i nyjeve të shpinës duke ruajtur standardet e referimit për institucionet e integruara në rrjet;
- 4.7.4 Projektimi dhe realizimi i zgjidhjeve teknologjike për krijimin e shpinës së rrjetit, e nyjeve të saj kryesore dhe të lidhjes së saj me institucionet e ndryshme, që të paktën në pjesën qendrore të veprave gjerësisht. Do të garantohet lidhja me internetin nëpërmjet operatorit vendor;
- 4.7.5 Realizimi i disa shërbimeve bazë të ofruara nga rrjeti, në mënyrë që të krijohet mundësia e përvetësimit të zhvillimeve të ardhshme;
- 4.7.6 Mirëmbajtja e programeve kompjuterike, e aparateve dhe e *server-ave* për tri vjet;
- 4.7.7 Asistencë e specializuar gjatë harkut kohor të trevjeçarit.
- 4.8 Veprimtari që kanë lidhje me rezultatin 8 (Personeli teknik informatik):
- 4.8.1 Formimi i personelit teknik për administrimin e Rrjetit Telematik Shqiptar, të pajisur me një gamë të gjerë kompetencash teknike dhe administruese;
- 4.8.2 Analizat e ofertës së tregut, të cilat kanë lidhje me programin kompjuterik administrues dhe përzgjedhja e zgjidhjes më të përshtatshme (blerje, ndryshime të paketave ose prodhim në vend);
- 4.8.3 Analizat e zgjidhjeve që kanë lidhje me platformat për administrimin e formimit *on line* dhe përzgjedhja e zgjidhjes më të përshtatshme (blerje/qira/ndryshim të programeve kompjuterike ekzistuese);
- 4.8.4 Blerja, instalimi dhe kolaudimi i produktit.
- 4.9. Përfutjesit
- Të drejtpërdrejtë:
- Rreth 15 të diplomuar universitarë do të fillojnë doktoraturat kërkimore shkencore;
 - Rreth 200 të diplomuar universitarë do të marrin pjesë në kurse për master dhe doktoraturë në Shqipëri dhe në Itali;
 - Mbi 100 docentë të universiteteve do të marrin pjesë në veprimtaritë e përditësimit *on line*;
 - Rreth 200 të diplomuar universitarë do të ndjekin një kurs vjetor specializimi të Arsimit dhe të Formimit Teknik të Lartë (IFTS) në vend;
 - Rreth 120 drejtues të administratës, në mënyrë që të kenë mundësinë që të zbatojnë metoda të reja administrimi, si dhe të administrojnë programe kompjuterike të zbatueshme;
 - Të paktën 4 operatorë për akreditimin, në mënyrë që të krijohet mundësia e zbatimit të standardeve të reja të cilësisë;
 - Të paktën 6 ekspertë shqiptarë do të përditësojnë njohuritë e tyre mbi normativat dhe mbi sistemin universitar italian dhe europian;
 - Të paktën 11 specialistë (një për secilin universitet) do të përditësohen mbi procedurat e pjesëmarrjes në tendera europianë;
 - Teknikë shqiptarë në gjendje që të administrojnë Rrjetin Telematik;
 - Personel i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës Shqiptare (MASH), operatorë të instituteve kërkimore shkencore të përfshirë në projekt.
- Jo të drejtpërdrejtë:
- Mbi 20 000 studentë të 11 institucioneve shqiptare të arsimit të lartë;
 - Docentë universitarë të interesuar jo drejtpërdrejt për veprimtaritë e formimit/përditësimit.
6. Institucione shqiptare të përfshira
- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës Shqiptare (MASH);
 - 11 universitete dhe institute të formimit të lartë shqiptar.
7. Institucione italiane të përfshira
- Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin në Zhvillim (DGCS) e Ministrisë së Punëve të Jashtme (MAE);
 - Konferenca e Rektorëve Italianë (CRUI);
 - Universitete italiane.
8. Përshkrimi i Qendrës Ndëruniversitare
- Qendra Ndëruniversitare do të krijohet menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes Ndërqeveritare, nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës Shqiptare (MASH), me një statut të posaçëm, i cili do të garantojë autonominë administrative dhe ekzekutive.
- Qendra do të ketë një Komitet Programimi dhe Drejtimi (CPI), me funksionet vijuese:
- a) Miratimi i planeve operative gjashtëmujore;

b) Miratimi i raporteve të veprimtarive tekniko-administrative;
c) Hartimi i propozimeve të mundshme të drejtimeve të reja, në lidhje me projektin fillestar të veprimtarive, në funksion të rezultateve të arritura ose të një evolucioni të kontekstit të përgjithshëm.

Planet operative të hartuara në periudhën e realizimit të projektit do t'i nënshtrohen Drejtorisë së Përgjithshme për Bashkëpunimin në Zhvillim (DGCS) për miratim.

Komiteti i Programimit dhe i Drejtimit (CPI) do të përbëhet nga anëtarët që vijojnë:

- a) Presidenti: Ministri ose përfaqësuesi i tij;
- b) Drejtori i Drejtorisë së Arsimit të Lartë Shqiptar;
- c) Tre përfaqësues të universiteteve shqiptare;
- d) Një përfaqësues i Konferencës së Rektorëve Italianë (CRUI);
- e) Mund të ftohen:
 - Një përfaqësues i Konferencës së Universiteteve Europiane;
 - Një përfaqësues i Këshillit të Europës;
 - Një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Universiteteve dhe Kërkimeve Shkencore (MIUR).

Qendra do të shfrytëzojë organikën vijuese:

- a) Një drejtor shqiptar;
- b) Tre ekspertë shqiptarë, me përvojë specifike në fushat që vijojnë:
 - në metodologjinë dhe në projektimin didaktik-kurrikular;
 - në administrimin e Rrjetit Telematik dhe të programeve kompjuterike;
 - në fushën juridiko-ligjore dhe atë të procedurave të administrimit të fondeve europiane;
- c) Tre njësi mbështetjeje për shërbimet e sekretarisë, të përkthimit dhe të kontabilitetit.

Drejtori dhe tre ekspertët shqiptarë do të përzgjidhen nëpërmjet një konkursi publik të posaçëm, nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës Shqiptare (MASH), sipas pikave të referimit në marrëveshje me Palën Italiane.

Për të zbatuar veprimtaritë e projektit, Qendra do të shfrytëzojë shërbimet e asistencës teknike dhe të formimit të ofruara nga një konsorcium universitar italian, i cili do të përzgjidhet nëpërmjet procedurave të konkursit.

9. Përshkrimi i Rrjetit Telematik Akademik Shqiptar

Struktura e Rrjetit Telematik Shqiptar do të përbëhet nga nivelet që vijojnë:

- Shpina qendrore në Tiranë, e cila do të bashkëlidhë nyjet e përcaktuara gjeografikisht pranë disa institucioneve akademike, e specializuar në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (ICT).

- Degëzime dytësore, të cilat do të bashkëlidhin nyjet gjysmëperiferike, të vendosura pranë disa prej institucioneve kryesore, përdoruese të Rrjetit Akademik të Shqipërisë (ANA).

- Degëzime tretësore, të cilat do të bashkëlidhin nyjet periferike, të krijuara në institucionet akademike të vendit.

Këto rrjete lokale nuk hyjnë në projekt, në gjendjen aktuale. Për to do të hartohen teknikat specifike të nevojshme për realizimin e mëtejshëm.

Bashkëlidhja e rrjeteve lokale me nyjet e shpinës qendrore do të kryhet sipas të njëjtave standarde të referimit, pavarësisht nga niveli i nyjeve dhe nga roli i institucioneve.

Në fazën e projektimit ekzekutiv do të përcaktohen mënyrat dhe strukturat tekniko-ekzekutive të administrimit, edhe në funksion të përgatitjes së ardhshme të institucioneve akademike dhe shkencore shqiptare.

10. Modalitetet e realizimit të projektit

Pas miratimit të financimit të iniciativës nga ana e Komitetit Drejtues për Bashkëpunimin në Zhvillim i Ministrisë së Punëve të Jashtme Italiane (MAE), Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim (DGCS) dhe Ministria e Arsimit dhe e Shkencës Shqiptare (MASH) do të nënshkruajnë një Marrëveshje Ndërqeveritare. Në këtë Marrëveshje do të parashikohet që transferimi i fondeve për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës Shqiptare (MASH) do të kryhet në disa pjesë, për financimin e punimeve, shërbimeve dhe pajisjeve të nevojshme për realizimin e projektit. Për të filluar projektin, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës Shqiptare (MASH) do të krijojë brenda saj një njësi për realizimin e projektit (Program Implementation Unit-PIU), e cila do të shfrytëzojë asistencën teknike të Drejtorisë së Përgjithshme për Bashkëpunimin në Zhvillim (DGCS) dhe të universiteteve dhe të instituteve shqiptare që do të përfitojnë nga kjo iniciativë.

10.1 Njësia për realizimin e projektit (PIU)

Brenda Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës Shqiptare (MASH) do të krijohet një njësi për realizimin e projektit (Program Implementation Unit-PIU), krahu operativ i Ministrisë për veprimtaritë zbatuese në kompetencat e veta dhe në ato të monitorimit. Në mënyrë të veçantë, PIU do të jetë përgjegjëse për prokurimet, do të nënshkruajë marrëveshjet dhe do të kujdeset për zbatimin e përpiktë të tyre. Gjithashtu, do të merret me hartimin e statutit të Qendrës, i cili do të miratohet nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës Shqiptare, pasi Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin në Zhvillim (DGCS) të jetë shprehur se nuk ka vërejtje të mundshme dhe pasi të jetë punësuar personeli shqiptar që do të përbëjë organikën e Qendrës.

Më hollësisht, njësia për realizimin e projektit (PIU) do të bëjë sa më poshtë vijon:

a) Do të përgatisë një plan për fillimin e veprimtarive, i cili do të duhet të miratohet si nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës Shqiptare (MASH), ashtu edhe nga Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin në Zhvillim (DGCS). Ky plan do të mbulojë periudhën fillestare të realizimit të projektit, deri sa të jetë krijuar Qendra Ndëruniversitare dhe të jetë miratuar plani i saj i parë operativ.

b) Për llogari të Qendrës së Shërbimeve për Universitetet, e cila është duke u krijuar, do të përgatisë kushtet e kontratës për tenderin që ka si qëllim blerjen e shërbimeve të konsulencës nga ana e një universiteti italian dhe/ose Konsorciumi Universitar Italian dhe do të zhvillojë procedurat e konkursit për përzgjedhjen e ofertës më të leverdishme, sipas mënyrave të parashikuara nga Marrëveshja Ndërqeveritare. Kontrata e konsulencës do të nënshkruhet nga Qendra dhe do të ketë të bëjë në mënyrë të përmblendhur, me asistencën teknike dhe të specializuar për Qendrën, për personelin e universiteteve dhe të instituteve kërkimore dhe të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës Shqiptare (MASH), në fushat kryesore vijuese:

- Studime mbi nevojat e arsimit të personelit shqiptar përfitues, me tituj dhe nivele të ndryshëm, të veprimtarive formuese të parashikuara nga projekti.

- Planifikimi didaktik dhe realizimi i kurseve që do të mbahen në Itali dhe në Shqipëri, duke përcaktuar dhe duke vlerësuar burimet vendase të disponueshme dhe duke i plotësuar ato me mundësitë e ofruara nga sistemi i arsimit universitar italian.

- Analiza e sistemit universitar shqiptar dhe përcaktimi i pikave të dobëta që mund të preken më shumë nga një veprim përforcimi, në drejtim të barazimit të sistemit të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor me ato italianë dhe europianë.

- Analiza e gjendjes së njohjes dhe e nivelit të futjes së sistemit universitar shqiptar në partneritetin europian dhe përcaktimi i veprimeve pasuese të përforcimit.

- Hartimi i një plani shpërndarjeje për në tregun kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar i shërbimeve të jashtme nga ana e universiteteve dhe e qendrave kërkimore.

- Ofrimi, sipas kërkesës, i konsulencës së specializuar dhe i mbështetjes për Komitetin e Programimit dhe të Drejtimit (CPI) për hartimin e planeve dhe të propozimeve të veprimtarive.

- Studim mbi gjendjen e lidhjeve telematike në kuadrin universitar dhe kërkimor, të planifikimit dhe të realizimit të Rrjetit Telematik.

- Planifikimi dhe shpërndarja e shërbimeve të përgjithshme, të formimit dhe të mbështetjes së kërkimeve, të ofruara nëpërmjet rrjetit.

c) Do të përgatisë kushtet e kontratës për tenderin që ka si qëllim blerjen e aparaturave dhe të shërbimeve për realizimin e Rrjetit Telematik, do të zhvillojë procedurat e konkursit për përzgjedhjen e ofertës më të leverdishme, sipas mënyrave të parashikuara nga Marrëveshja Ndërqeveritare dhe do të nënshkruajë kontratën përkatëse me një furnizues italian.

d) Do të monitorojë projektin për llogari të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës Shqiptare (MASH), gjatë gjithë periudhës së realizimit.

Për të kryer detyrat e përmendura më sipër, njësia për realizimin e projektit (PIU) mund të përfitojë një mbështetje financiare italiane, si dhe asistencën teknike të ekspertëve të dërguar nga Zyra e Bashkëpunimit e Ambasadës së Italisë në Shqipëri.

11. Kostot në ngarkim të Palës Italiane

Projekti do të ketë një kohëzgjatje trevjeçare. Pala italiane do të marrë përsipër ofrimin e burimeve financiare falas, për një shumë prej 4 000 000,00 eurosh, prej të cilave shuma prej 3 600 000,00 eurosh do të vihet në dispozicion të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës Shqiptare (MASH), ndërsa shuma prej 400 000,00 eurosh në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme për Bashkëpunimin në Zhvillim (DGCS) dhe të Ambasadës së Italisë/Zyrës Teknike Vendore të Bashkëpunimit në Tiranë.

Fondet në dispozicion të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës Shqiptare (MASH) do të jepen

në tre pjesë, përkatësisht 400 000,00 euro, 2 300 000,00 euro dhe 900 000,00 euro dhe do të përdoren për të mbuluar kostot e paraqitura në mënyrë të përmblendhur në tabelën vijuese.

Zërat e kostos	Kostoja (€)
1. Funksionimi i njësisë për realizimin e projektit (PIU)	151.655,00
a) Plotësimi i rrogave të personelit	46.800,00
b) Auditim	104.855,00
2. Qendra e Shërbimeve për Universitetet	1.802.845,00
a) Rehabilitimi dhe pajimi	122.600,00
b) Rroga dhe plotësimi i rrogave	105.840,00
c) Rimbursimi i shpenzimeve të anëtarëve të CPI-së	14.250,00
d) Shpenzime të tjera rrjedhëse	57.500,00
e) Asistencë dhe formim për Qendrën (me kontratë)	1.502.655,00
3. Rrjeti Telematik për universitetet	1.645.500,00
a) Rroga më vete të personelit	63.450,00
b) Shpenzime të tjera rrjedhëse	29.250,00
c) Pajisje kompjuterike, programe kompjuterike, lidhje dhe formim (me kontratë)	1.552.800,00
Shuma gjithsej	3.600.000,00

Vëllimi dhe ndarja e kostove të projektit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës Shqiptare (MASH), Drejtorisë së Përgjithshme për bashkëpunimin në Zhvillim (DGCS) dhe Ambasadës së Italisë/Zyrës Teknike Vendore të bashkëpunimit në Tiranë, janë llogaritur duke pasur parasysh, në mënyrë të veçantë sa më poshtë vijon:

a) Pagat e personelit të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës Shqiptare (MASH) dhe të administratave të tjera publike shqiptare, me përjashtim të personelit në organikën e Qendrës, siç është treguar më sipër në paragrafin 8, nuk i ngarkohen fondeve të projektit. Sidoqoftë, do të njihen plotësime page për personelin e Njësisë për Realizimin e Projektit (PIU), duke pasur parasysh ngarkesën më të madhe të punës, që sipas gjasave mund të kenë, si dhe rimbursimin e shpenzimeve të anëtarëve të Komitetit të Programimit dhe të Drejtimit (CPI) për veprimtaritë, të cilat janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me projektin;

b) Përsa u përket Qendrës së Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik, Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin në Zhvillim (DGCS) do të marrë përsipër:

- një pjesë të kostove të rristurimit dhe të pajisjes së selisë, për të cilat bëhet fjalë në pikën 2a, brenda kufijve të shumës së paraqitur në tabelë.

- kostot e dy kontratave, për të cilat bëhet fjalë në pikat 2e, dhe 3c;

- për dy vitet e para të projektit, 100% e kostove të funksionimit, për të cilat bëhet fjalë në pikat 2b, 2c, 2d, 3a e 3b, të paraqitura në mënyrë të qartë në këtë dokument;

për vitin e tretë të projektit, 50% të kostove të funksionimit, për të cilat bëhet fjalë në pikat 2b, 2c, 2d, 3a e 3b, të paraqitura në mënyrë të qartë në këtë dokument;

c) Nuk u ngarkohen fondeve të vëna në dispozicion të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës Shqiptare (MASH) pagat e personelit të Qendrës, i cili nuk është përmendur, (si për shembull, rojet, korrierët, shoferët, personeli i pastrimit etj.), si dhe shpenzimet për shërbimet publike (ujë, energji elektrike, gaz);

d) Fondet e vëna në dispozicion nuk do të mund të përdoren për të paguar taksat dhe detyrime doganore në Shqipëri.

Tabela e bashkëngjitur në vijim paraqet kostot e projektit në mënyrë më të hollësishme.

12. Kostot në ngarkim të Palës Shqiptare

Pala Shqiptare do të sigurojë mbulimin, me burimet e veta financiare dhe me hyrjet që do të përfitohen nga shitja e shërbimeve të Qendrës, e kostove për realizimin e projektit dhe për funksionimin e Qendrës dhe të Rrjetit Telematik, të cilat nuk u ngarkohen fondeve të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin në Zhvillim (DGCS).

Në mënyrë të veçantë, Pala Shqiptare do të marrë përsipër sa më poshtë vijon:

a) kostot e selisë së Qendrës;

- b) pagat e personelit të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës Shqiptare (MASH) dhe të administratave të tjera publike shqiptare, të cilat janë përfshirë në projekt, si dhe të personelit të Qendrës ose të specialistit të Rrjetit Telematik që nuk janë përmendur qartë në ngarkim të projektit;
- c) në vitin e tretë të projektit, 50% të kostove të funksionimit të Qendrës, të cilat në vitet e mëparshme kanë qenë të mbuluara nga fondet italiane;
- d) në vitet e mëtejshme, 100% të kostove të funksionimit të Qendrës;
- e) kostot e ushtrimit të Rrjetit Telematik nga viti i tretë dhe në vazhdim, të llogaritura mbi bazën e çmimeve të tanishme, për një shumë prej rreth 386.000 eurosh në vit;
- f) Të gjitha taksat dhe detyrimet doganore në Shqipëri.

LIGJ
Nr.9709, datë 10.4.2007

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË
REHABILITIMIT DHE NDËRTIMIT TË RRUGËS FIER (LEVAN) – TEPELENË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të rehabilitimit dhe ndërtimit të rrugës Fier (Levan) – Tepelenë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5270, datë 17.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

AK/ft 34637/Marrëveshja e Huasë 9003
Nr.Operacional 34637 20/04/05

MARRËVESHJA E HUASË
PROJEKTI I REHABILITIMIT TË RRUGËS FIER-TEPELENË MIDIS REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

MARRËVESHJE e datës _____ 2005 midis Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka).

HYRJE

Duke pasur parasysh se Banka është krijuar për financimin e projekteve specifike për tranzicionin e ekonomive të orientuara drejt tregut të hapur, si dhe për të nxitur iniciativat private dhe sipërmarrjet në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore të angazhuara dhe që zbatojnë parimet e

1276

demokracisë, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;

se Huamarrësi synon të zbatojë projektin e përshkruar në skedulin 1 (Projekti), që është dizenuar për të ndihmuar Huamarrësin në rehabilitimin dhe ndërtimin e seksionit prej 70 km të rrugës Fier-Tepelenë, në aksin veri-jug;

se Huamarrësi ka kërkuar asistencë nga Banka për financimin e një pjese të projektit;

se sikurse është rënë dakord më parë, Banka do të mundësojë Huanë për Huamarrësin për një shumë prej 35 milionë euro (tridhjetë e pesë milionë euro), subjekt i termave dhe kushteve të paraqitura apo referuar kësaj Marrëveshjeje; dhe

se Banka Europiane e Investimeve (BEI) është në procesin e bisedimeve, në vijim të një marrëveshjeje të veçantë me Huamarrësin, për një hua në shumën prej 50 milionë euro (pesëdhjetë milionë euro), për të bashkëfinancuar pjesët A dhe B të projektit (Huaja e BEI-t); dhe Bashkimi Europian (BE) ka rënë dakord, në vijim të një marrëveshjeje të veçantë me Huamarrësin, të japë një fond grant për të financuar pjesën C të Projektit (Fondi grant i BE-së),

atëherë pjesëmarrësit këtu bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Termat dhe kushtet standarde; përkufizimet

Seksioni 1.01 Përfshirja e termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të Bankës, së shkurtit 1999, janë përfshirë në këtë Marrëveshje, si dhe janë bërë të zbatueshme me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur janë paraqitur plotësisht këtu, megjithatë janë subjekt i modifikimeve të mëposhtme (të tilla masa të modifikuara do të quhen më tej “Termat dhe kushtet standarde”):

a) Përcaktimi i “Ditës së punës” në seksionin 2.02 të termave dhe kushteve standarde të Bankës, të shkurtit 1999, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, do të modifikohet si më poshtë:

“Dita e punës” nënkupton një ditë (përveç të shtunës, apo të dielës), në të cilën bankat tregtare janë të hapura për transaksione të biznesit (duke përfshirë veprimet me shkëmbime në monedhë të huaj, si dhe depozitat në monedhë të huaj) në Londër, Angli, dhe në të cilën është i hapur sistemi i automatizuar transeuropian i transfertave të shpejta për shumat në kohë-reale (TARGET).

b) Përkufizimi i “Kostos së shpërbërë”, në seksionin 2.02 të termave dhe kushteve standarde të Bankës, të shkurtit 1999, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të modifikohet si më poshtë:

“Kosto e shpërbërë” nënkupton shumën me të cilën niveli origjinal i të ardhurave tejkalon nivelin e të ardhurave zëvendësuese, ku:

a) “Niveli origjinal i të ardhurave” nënkupton shumën e vlerave aktuale të pagesave të principalit dhe interesave, të cilat Banka duhet t’i paguajë gjatë periudhës së përlllogaritjeve (siç është përcaktuar më poshtë) mbi pjesën e huasë që është subjekt i një norme fikse interesi, nëse një parapagesë e tillë, përshpejtim apo anulim nuk do të ndodhin, dhe nëse interesi rritet mbi këtë pjesë të huasë në tregun relevant të normave të interesit për një pjesë të tillë huaje.

b) “Niveli i të ardhurave zëvendësuese” nënkupton shumën:

1. e totalit të vlerave aktuale të çfarëdo pagese të mbetur nga principalit dhe interesi, që pasi të jetë marrë në konsideratë një parapagesë e tillë, përshpejtim apo anulim, do të paguhet nga Banka gjatë periudhës së përlllogaritjeve mbi pjesën e huasë që është subjekt i një norme fikse interesi, nëse interesi rritet mbi këtë pjesë të huasë në tregun relevant të normave të interesit për një porcion të tillë huaje; dhe

2. siç zbatohet:

A) në rastin e një parapagese sipas seksionit 3.07 të termave dhe kushteve standarde, vlera aktuale e shumës së huasë për t’u parapaguar përcaktohet duke skontuar këtë shumë nga data kur ndodh kjo parapagesë deri në datën e llogaritjeve (siç është përcaktuar më poshtë) në normë skontimi (siç është përcaktuar më poshtë); dhe/ose

B) në rast të ndonjë parapagese tjetër, shumta e huasë që është parapaguar; dhe/ose

C) në rast të ndonjë përshpejtimi, vlera aktuale e shumës së huasë që është përshpejtuar, e përcaktuar nga skontimi i kësaj shume nga data në të cilën ky përshpejtim bëhet efektiv deri në datën e llogaritjes me normë skontimi; dhe/ose

D) në rast të një pezullimi, vlera aktuale e shumës së huasë që është pezulluar, e përcaktuar nga skontimi i kësaj shume nga data e fundit e disponueshmërisë deri në datën e llogaritjes me normë

skontimi.

c) Për qëllime të paragrafëve (a) dhe (b)(1) më lart, vlera aktuale e çdo pagese të principalit dhe interesit do të përcaktohen nga skontimi i shumës së kësaj pagese nga data e pagesës deri në datën e llogaritur duke përdorur normën e skontimit.

d) “Data e llogaritjes” nënkupton:

1. në rastin e një pagese, sipas seksionit 3.07 të termave dhe kushteve standarde, është data dy ditë pune para datës së afatit të kësaj parapagese, ose sipas opsionit të Bankës, data në të cilën është afati i kësaj parapagese;

2. në rastin e çdo lloj parapagese tjetër, data në të cilën është bërë kjo parapagesë, apo një datë tjetër e mëvonshme e zgjedhur nga vetë Banka; dhe

3. në rast përshpejtimi apo pezullimi, dita dy ditë pune para datës së bërjes efektive të përshpejtimit apo pezullimit, apo me përzgjedhje nga Banka, dita në të cilën një përshpejtim apo anulim i tillë bëhen efektiv.

e) “Periudha e llogaritjes” nënkupton:

1. në rastin e një parapagese, në përputhje me seksionin 3.07 të termave dhe kushteve standarde, periudhën që fillon në datën e afatit të kryerjes së parapagesës dhe përfundon në datën e shlyerjes së huasë;

2. në rast të ndonjë parapagese tjetër, periudha që shtrihet nga data në të cilën bëhet kjo parapagesë, apo një datë e mëvonshme e zgjedhur nga vetë Banka, dhe përfundon në datën e shlyerjes përfundimtare të huasë; dhe

3. Në rast të një përshpejtimi apo pezullimi, është periudha që shtrihet nga data në të cilën përshpejtimi apo pezullimi është bërë efektiv dhe përfundon në datën e shlyerjes përfundimtare të huasë.

f) “Norma e skontimit” nënkupton faktorin skontues për maturimin e përshtatshëm që rrjedh nga kurba normale “swap” për monedhën e huasë, që është e disponueshme nga Banka në tregun e “Swapeve” dhe opsioneve në datën e llogaritjes.

e) Seksioni 3.10 i termave dhe kushteve standarde të Bankës, i shkurtit 1999, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, do të modifikohet si më poshtë:

“Seksioni 3.10. Kosto e shpërbërë”

a) Nëse për çfarëdo arsye (duke përfshirë dhe një përshpejtim pa kufizime në vijim të seksioni 7.06 të termave dhe kushteve standarde), cilido porcion i huasë që është subjekt i një norme interesi të ndryshueshme ka afat dhe bëhet i pagueshëm në një datë përveç asaj të ditës së fundit të një periudhe interesi, Huamarrësi do t’i paguajë Bankës këtë shumë sipas kërkesës, në të cilën:

1. interesi që do të ishte akumuluar për këtë pjesë të huasë nga data në të cilën huaja duhet të kishte mbaruar deri në ditën e fundit të periudhës së përcaktuar të interesit me normë të barabartë me normën aktuale të interesit në treg për këtë porcion të huasë për një periudhë të tillë interesi;

kalon në:

2. interesi që Banka do të ishte në gjendje të merrte, nëse do ta vendoste një shumë të barabartë me një pjesë të tillë të huasë në një depozitë me një bankë lider në tregun e eurozonës për periudhën që shtrihet në datën kur një porcion i tillë i huasë ka arritur afatin dhe është i pagueshëm deri në ditën e fundit të periudhës aktuale të interesit.

b) Nëse në çfarëdo kohe:

1. Huamarrësi paraqet një njoftim, në vijim të seksionit 3.07 të termave dhe kushteve standarde, për parapagimin e çfarëdo porcioni të huasë që është subjekt i një norme interesi fikse, ose në të kundërt, Huamarrësi parapaguan çdonjërin prej pjesëve të tilla të huasë;

2. çdo pjesë e huasë, që është subjekt i një norme fikse interesi, përshpejtohet në vijim të seksionit 7.06 të termave dhe kushteve standarde, ose në të kundërt, duhet paguar përpara maturitetit të caktuar; ose

3. çdo porcion i huasë, që është subjekt i një norme fikse interesi, anulohet në përputhje me seksionet 3.08, 7.02, ose 7.06 të termave dhe kushteve standarde;

Huamarrësi, përveç ndonjë parapagese të një tarife administrative, tarife anulimi apo ndonjë shume tjetër të pagueshme lidhur me këtë, duhet t’i paguajë Bankës shumën e çfarëdo kostoje të shpërbërë; duke pasur parasysh se nëse shumën e një kostoje të tillë të shpërbërë është negative, Banka do të kreditojë të Huamarrësi shumën e kostove të shpërbëra në datën më të afërt të pagesës së interesit në monedhën e huasë.

c) Nëse ndonjë shumë së cilës i ka kaluar afati paguhet në një datë, përveç asaj të ditës së fundit të mospagimit të periudhës së interesit, Huamarrësi duhet t'i paguajë Bankës shumën, nëse:

1. interesi që do të jetë akumuluar mbi këtë shumë të papaguar nga data e faturimit të kësaj shume të papaguar deri në datën e fundit të mospagimit të periudhës së interesit me një normë të barabartë me atë të përcaktuar në seksionin 3.09(a)(iii) të termave dhe kushteve standarde për një periudhë të tillë mospagimi të interesit;

kalon në:

2. interesi që Banka do të ishte në gjendje të merrte nëse do të vendoste një shumë të barabartë me atë të shumës së papaguar në një depozitë të një banke lider në tregun interbank të eurozonës për periudhën që shtrihet nga data e faturimit të shumës së papaguar deri në ditën e fundit të periudhës aktuale të interesit të papaguar.

d) Një certifikatë nga Banka për çdo shumë të pagueshme nën këtë seksion 3.10 do të jetë përfundimtare, vendimtare dhe detyruese për Huamarrësin, por jo në ato raste kur nga ana e Huamarrësit në përputhje me kërkesat e Bankës tregohet se ajo përmban gabime të dukshme.”

Seksioni 1.02 Përkufizimet

Kudo që të haset në këtë Marrëveshje (duke përfshirë si hyrjen, ashtu edhe skedulet), vetëm nëse është thënë me kuptim tjetër apo ka kuptim tjetër në kontekst, termat e përcaktuar në hyrje kanë kuptime respektive si ato të dhëna këtu, termat e përcaktuar në termat dhe kushtet standarde kanë kuptime respektive si ato të dhëna këtu, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit” nënkupton Ministrin e Financave të Huamarrësit, me përjashtim të rasteve të specifikuara në seksionin 2.03(c).

“BEI” ka kuptimin e atribuar në hyrje të kësaj Marrëveshjeje.

“Huaja e BEI” ka kuptimin e atribuar në hyrje të kësaj Marrëveshjeje.

“BE” ka kuptimin e atribuar në hyrje të kësaj Marrëveshjeje.

“Fonded grant të BE-së” ka kuptimin e atribuar në hyrje të kësaj Marrëveshjeje.

“Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin” nënkupton vlerësimin e ndikimit të projektit mbi mjedisin, përgatitur nga konsulentë të financuar nga BE, Scetauroute, dhe në veçanti drafti i quajtur si “3a” në “Drafraportin përfundimtar” të datës 11 shkurt 2005.

“Plani i menaxhimit të mjedisit” nënkupton planin e menaxhimit të mjedisit, si dhe planin e monitorimit të mjedisit për projektin, bazuar në rekomandimet mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis, që duhet rënë dakord midis Huamarrësit dhe Bankës dhe në formë e përmbajtje të jetë i pranueshëm nga Banka, duke pasur parasysh mjedisin e lidhur me projektin, shëndetin dhe sigurinë, zbutjen e elementeve sociale, masat mbi menaxhimin dhe monitorimin, standardet, praktikën, politikat dhe procedurat, siç janë amenduar herë pas here me miratim paraprak të shkruar nga Banka. Plani i menaxhimit të mjedisit gjatë fazës së ndërtimit është pjesë e specifikimeve teknike të punëve të tenderuara për t’u ndjekur nga kontraktori(ët). Plani i menaxhimit të mjedisit gjatë fazës së zbatimit është përgjegjësi e Huamarrësit

“Viti fiskal” nënkupton vitin fiskal të Huamarrësit, që fillon më 1 janar të çdo viti.

“Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve” nënkupton Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve pranë Ministrisë së Transportit.

“Data e kthimit të interesit” nënkupton një datë të pagesës së interesit të përcaktuar nga Huamarrësi si e tillë në përputhje me seksionin 2.02(h)(2)(B).

“Data e përcaktimit të interesit” nënkupton, për çfarëdo periudhe interesi, datën dy ditë pune përpara ditës së parë të kësaj periudhe interesi.

“Data e fiksimit të interesit” nënkupton një ditë pune të zgjedhur nga Huamarrësi si e tillë në përputhje me seksionin 2.02(h)(2)(B).

“Të drejtat mbi tokën” nënkupton të drejtat e përdorimit të tokës, të nevojshme për zbatimin e pjesës A dhe B të projektit.

“Ministri i Financave” nënkupton Ministrin e Financave të Republikës së Shqipërisë.

“Ministri i Drejtësisë” nënkupton Ministrin e Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë.

“Ministri i Transportit” nënkupton Ministrin e Transportit dhe Telekomunikacionit të Republikës së Shqipërisë.

“Plani Kombëtar i Transportit” nënkupton Planin Kombëtar Shqiptar, të përgatitur nga Huamarrësi, me mbështetje nga konsulentë të financuar nga BE-ja.

“Data e përfundimit të projektit” nënkupton datën në të cilën projekti është përfunduar siç

përshkruhet në skedulin 1.

“PIU” ka kuptimin siç është përshkruar në seksionin 3.06 të kësaj Marrëveshjeje.

“Façe referuese” nënkupton paraqitjen e normave të ofruara nga Interbank e eurozonës për depozitat në monedhën e huasë të përcaktuara si façe 248 në Moneyline Telerate (apo një façe e tillë tjetër që mund të zëvendësojë faqen 248 në Moneyline Telerate, për qëllime të paraqitjes të normave të ofruara nga Interbank Eurozonë për depozitat në monedhën e huasë).

“Program ristrukturimi” nënkupton program ristrukturimi që duhet zhvilluar nga Huamarrësi, bazuar në Planin Kombëtar të Transportit, që do të shërbejë për të drejtuar zhvillimet, operacionin, administrimin dhe menaxhimin e sektorit rrugor, në përputhje me seksionin 3.02 të kësaj Marrëveshjeje.

“RUCs” nënkupton “Tarifat e përdoruesve të rrugës” dhe përfshin tarifat e fokusuara te përdoruesit e rrugës, që përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me: (i) taksat e karburantit, paguar në funksion të përdorimit të automjetit; (ii) taksat vjetore mbi pronësinë e automjetit; (iii) taksa të tjera të paguara nga përdoruesit e rrugës; dhe (iv) taksa të tjera të përgjithshme, si TVSH, si dhe taksat e importeve për blerjen e inputeve (automjete, karburant, pjesë këmbimi, goma, etj.), të paguara nga përdoruesit e rrugës dhe të vendosura në të gjithë sistemin e ekonomisë.

“Rrugët shtetërore” nënkupton rrugët shtetërore të menaxhuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

“Strategjia për reformën e financimit të sektorit rrugor” nënkupton strategjinë për reformën e financimit të sektorit rrugor, që rishikon RUCt dhe financimin e sektorit rrugor, si dhe përcakton nivelin e qëndrueshëm të shpenzimeve për mirëmbajtje vjetore të rrugëve, për rrugët shtetërore që do të financohen nga një tarifë mikse, e përbërë nga tarifat e përdoruesve të rrugëve dhe transfertat buxhetore, si dhe përfshin kalendarin e zbatimeve për të arritur një nivel të qëndrueshëm në vitin 2012. Kjo strategji duhet përgatitur nga Huamarrësi në përputhje me parashikimet e dhëna në seksionin 3.03(b), (c) dhe (d) të kësaj Marrëveshjeje.

“Niveli i qëndrueshëm” nënkupton një nivel të shpenzimeve vjetore për mirëmbajtje të rrugëve shtetërore, që shërben për të garantuar se rrjeti i rrugëve shtetërore mirëmbahet në një nivel të qëndrueshëm cilësor shërbimi, me shpenzime nga fondet RUC, si dhe burime të tjera nga buxheti (nëse kërkohet dhe atëherë kur kërkohet të kryhen këto shpenzime), ashtu siç është përcaktuar në pjesën e përgatitjes së strategjisë për reformën e financimit të sektorit rrugor.

Seksioni 1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje (referuar një neni specifik), seksioni apo skeduli (me përjashtim të rasteve që nuk paraqiten në këtë Marrëveshje) do të paraqiten si referencë për atë nen apo seksion specifik, apo skedul, në këtë Marrëveshje.

Neni 2

Termat kryesorë të huasë

Seksioni 2.01 Shuma dhe monedha

a) Bazuar në termat dhe kushtet e parashtruara në këtë Marrëveshje, Banka bie dakord të japë hua për Huamarrësin një sasi prej tridhjetë e pesë milionë euro (eur 35,000,000).

Seksioni 2.02 Terma të tjerë financiarë mbi huanë

a) Sasia minimale për tërheqje do të jetë treqind mijë euro (eur 300,000).

b) Sasia minimale e parapagesës do të jetë pesë milion euro (eur 5,000,000).

c) Sasia minimale e anuluar do të jetë një milion euro (eur 1,000,000).

d) Data e pagesës së interesit do të jetë 25 maj dhe 25 nëntori i çdo viti.

e) (1) Huamarrësi do të paguajë huanë në 24 këste të barabarta (apo afërsisht të barabarta), në periudha gjashtëmujore, me afate në datat e caktuara të pagesës së interesit, duke filluar nga 25 nëntori 2008.

2. Pavarësisht, çfarë është paraqitur më lart, në rast se (i) Huamarrësi nuk tërheq të gjithë shumën e huasë para datës së parë të ripagimit të specifikuar në seksionin 2.02.(e), dhe (ii), Banka e shtyn datën e fundit të disponueshmërisë të specifikuar në seksionin 2.02 (f) më poshtë në një datë e cila bie pas kësaj date ripagimi, ndaj shuma e kësaj tërheqjeje të bërë në apo pas datës së parë të ripagimit duhet të shpërndahet për ripagim në shuma të barabarta në data të ndryshme të ripagimit të

huasë, të cilat janë pas datës së kësaj tërheqjeje (ku Banka rregullon shumat e shpërndara në mënyrën më të mirë të mundshme). Banka herë pas here duhet të njoftojë Huamarrësin për këtë shpërndarje.

f) Data e fundit e disponueshmërisë duhet të jetë 1 nëntor 2008, apo një datë tjetër e mëvonshme, që vendoset nga vetë Banka dhe për të cilën Huamarrësi vihet në dijeni. Nëse shumata e huasë së disponueshme apo çdo lloj pjese tjetër e saj është subjekt i një norme fikse interesi, çdo shtyrje e datës së fundit të disponueshmërisë mund të sjellë kosto të shpërbëra, që do të jenë menjëherë të pagueshme nga Huamarrësi apo Banka sipas rastit.

g) Tarifa e angazhimit do të jetë 0.5% në vit.

h) Normat e interesit

1. Huaja është subjekt i normave të ndryshueshme të interesit. Për qëllime të seksionit 3.04 (b) të termave dhe kushteve standarde, norma e interesit në treg do të jetë norma vjetore e ofruar për depozita në monedhën e huasë që paraqitet në faqen referuese në orën 11:00 A.M. të Brukselit, në datën e përcaktuar të interesit për periudhën që është më pranë kohëzgjatjes së periudhës së interesit (ose nëse dy periudha janë njëlloj afër kohëzgjatjes së periudhës së interesit, mesatarja e këtyre dy normave), duke pasur parasysh se:

A) nëse për çfarëdo arsyeje norma e interesit në treg nuk mund të përcaktohet duke iu referuar faqes referuese, norma e interesit të tregut do të jetë norma në të cilën Banka përcakton si mesatare aritmetike (e rrumbullakosur me shifrën më të afërt të 1/16%) të normave vjetore të ofruara për depozitat në monedhën e huasë për një shumë të krahasueshme me pjesën e huasë të skeduar për të qenë e papaguar përgjatë periudhës së interesit në një periudhë të barabartë me këtë periudhë interesi, të cilat janë normat e tri bankave më të mëdha që operojnë në tregun ndërbankar të Brukselit të zgjedhura nga Banka; dhe

B) nëse Banka përcakton se depozitat në monedhën e huasë nuk ofrohen në tregun ndërbankar të Brukselit në të tilla shumata apo në të tilla periudha, norma e interesit të tregut do të jetë kostoja e Bankës (e shprehur si normë vjetore) e financimit të pjesës së huasë, e caktuar për të qenë e papaguar përgjatë periudhës së interesit nga çfarëdo burimi që Banka zgjedh.

2. Pavarësisht çfarë është paraqitur më lart, Huamarrësi mund që, si një alternativë për pagesën e normës së ndryshueshme të interesit mbi të gjithë apo ndonjë pjesë të huasë në atë moment të pa paguar, të zgjedhë të paguajë interesin me një normë fikse interesi mbi këtë pjesë të huasë si më poshtë:

A) Huamarrësi mund të ushtrojë këtë opsion, nëse:

i) në kohën e ushtrimit të këtij opsioni nuk ndërmerret ndonjë veprim sipas seksionit 7.01 të termave dhe kushteve standarde (dhe asnjë veprim që do të shihet dhe/apo me kalimin e kohës do të jetë i tillë), pra ky veprim nuk ka ndodhur dhe apo ndodhë; dhe

ii) shumata e principalit të huasë që po konvertohet nga një normë e ndryshueshme interesi në një normë fikse nuk është më e vogël se 5 milionë euro (eur 5,000,000).

B) Huamarrësi duhet të ushtrojë një opsion të tillë duke njoftuar Bankën jo më pak se pesë ditë pune para datës së propozuar të datës së përcaktimit të interesit. Ky njoftim, me përjashtim të rasteve të paaprovuara nga Banka, është i pakthyeshëm dhe do të specifikojë datën e fiksimit të interesit dhe datën e konvertimit të interesit të zgjedhur nga Huamarrësi, si dhe shumën e principalit të huasë që do të konvertohet në një normë fikse interesi.

C) Duke filluar nga data e konvertimit të interesit, pjesa e huasë së konvertuar (siç specifikohet në njoftimin e Huamarrësit) do të jetë subjekt i një norme fikse interesi. Për qëllime të seksionit 3.04(a) të termave dhe kushteve standarde, norma e interesit të tregut do të jetë normë fikse e avancuar e interesit për monedhën e huasë që është e disponueshme në Bankë në normën e interesit të tregut “swap” në një datë të tillë të caktimit të interesit për periudhën, që fillon në një datë të tillë konverimi dhe që mbaron me datën e pagesës përfundimtare të huasë, duke marrë parasysh ripagimin e principalit, si dhe kalendarin e pagesave për huanë. Banka do të përcaktojë normën fikse të interesit në një datë të tillë të caktimit të interesit dhe do të njoftojë në kohë Huamarrësin për këtë.

D) Në çdo kohë Banka mund të zgjedhë të konsolidojë të gjitha normat fikse të interesit të aplikueshme mbi pjesët e huasë në një normë të vetme fikse interesi, e barabartë me mesataren e normave fikse të interesave të aplikueshme mbi pjesët të huasë. Banka do të përcaktojë një normë të tillë interesi të konsoliduar dhe në kohë të japë njoftim Huamarrësit për këtë. Një normë e tillë interesi

e konsoliduar do të jetë e aplikueshme mbi të gjitha pjesët e huasë, pastaj do të sillet në vlerat e normave fikse të interesit, që fillojnë në datën e pagesës së interesit menjëherë pas njoftimit të bërë nga Banka për Huamarrësin.

Seksioni 2.03 Tërheqjet

a) Sasia e disponueshme mund të tërhiqet nga një periudhë në tjetrën në përputhje me parashikimet e bëra në skedulën 2, për të financuar (1) shpenzimet e bëra (ose, nëse Banka bie dakord që këto të realizohen), në përputhje me kostot e arsyeshme të punimeve të kërkuara për projektin, dhe (2) komisionin përmbyllës.

b) Huamarrësi autorizon Bankën që të tërheqë nga shuma e disponueshme një sasi të barabartë me komisionin përmbyllës dhe të paguajë komisionin përmbyllës të saj në emër të Huamarrësit.

c) Ministri i Financës është emëruar si përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit për çdo veprim që kërkohet të ndërmerret apo lejohet të ndërmerret në përputhje me seksionin 3.01 dhe 3.02 të termave dhe kushteve standarde, me përjashtim të rasteve kur Ministri i Financave, herë pas here, mund të caktojë ndonjë anëtar për të vepruar si përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit lidhur me veprime të tilla.

Neni 3

Zbatimi i projektit

Seksioni 3.01 Angazhime të tjera të aprovuara

Përveç angazhimeve të përgjithshme të paraqitura në nenet IV dhe V të termave dhe kushteve standarde, Huamarrësi, me pëlqim të Bankës:

a) do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të dhënë fondet e nevojshme për përfundimin e projektit dhe t'i vërë të gjitha këto fonde në dispozicion të projektit si një kontribut i parimbursueshëm për financimin e kostos së projektit.

b) do të tërmbushë të gjitha detyrimet nën marrëveshje të tjera apo në përputhje me to për fondet grant të BE-së, si dhe të gjitha kontratat e tjera në lidhje me projektin.

Seksioni 3.02 Angazhimet për fuqizimin institucional

a) Më 30 qershor 2006 Huamarrësi do të zhvillojë një program kombëtar bashkëkohor dhe të integruar mbi ristrukturimin e transportit, ku përfshihet një plan veprimi i detajuar, bazuar në planin kombëtar të transportit, që do të mund të drejtojë zhvillimin, operimin, administrimin dhe menaxhimin e sektorit rrugor. Një program i tillë do të jetë në formë dhe përmbajtje i pranueshëm nga Banka dhe do të zbatohet në përputhje me kalendarin kohor të paraqitur.

b) Më apo përpara datës 15 tetor të çdo viti, Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës një draftprogram investimesh trevjeçar për mirëmbajtje dhe investime për rrjetin rrugor kombëtar; dhe më apo përpara datës 31 janar të çdo viti, Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës versionin përfundimtar të programit trevjeçar të mirëmbajtjes dhe investimeve, të aprovuar nga Ministria e Transportit.

Seksioni 3.03 Angazhimet për mbështetje financiare

a) Huamarrësi duhet të garantojë se niveli i shpenzimeve vjetore për mirëmbajtje të rrugëve për rrugët shtetërore nuk do të jetë më i vogël se (euro 10,000,000) dhjetë milionë euro për vitin 2006 dhe (euro 12,000,000) dymbëdhjetë milionë euro për vitin 2008.

b) Më 30 qershor 2006 Huamarrësi duhet të përgatisë strategjinë për reformën e financimit të sektorit rrugor, që në formë e përmbajtje duhet të jetë i pranueshëm nga Banka.

c) Më 31 dhjetor 2006 Huamarrësi duhet të ketë dorëzuar dhe të ketë marrë të aprovuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dokumentin e strategjisë së reformës së financimit të sektorit rrugor.

d) Duke ndjekur aprovimin e strategjisë për reformën e financimit të sektorit të rrugëve nga ana e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Huamarrësi duhet të mundësojë zbatimin e strategjisë, në përputhje me afatet kohore të paraqitura në të, dhe duhet të sigurojë se do të arrihet një nivel i qëndrueshëm nga fundi i vitit 2012.

Seksioni 3.04 Mënyra e raportimit dhe paraqitja e dokumenteve

a) Deri në përfundim të projektit, Huamarrësi duhet të paraqesë pranë Bankës të dhënat e projektit, si dhe raportet e lidhura me projektin, siç është specifikuar në seksionin 4.04 të termave dhe kushteve standarde, dhe siç specifikohen më tej më poshtë.

b) Raportet periodike të projektit referuar seksionit 4.04 (a)(iv) të termave dhe kushteve

standarde duhet të paraqiten çdo tremujor, brenda 30 ditëve të periudhës së raportuar, kjo deri në përfundim të projektit. Këto raporte do të përmbajnë elementet specifike, si më poshtë:

i) informacion të përgjithshëm, si më poshtë:

1. progresin fizik të përmbushur në zbatim të projektit deri në datën e raportimit dhe gjatë periudhës së raportimit;

2. progresi lidhur me zbatimin e lehtësimit të punimeve në mjedis në përputhje me seksionin 3.04 (e);

3. vështirësitë aktuale apo ato të pritshme, sikurse dhe vonesat në zbatim të projektit, si dhe ndikimin e tyre në kalendarin e zbatimit, si dhe hapat konkretë të marrë apo të planifikuar për të kaluar vështirësitë dhe shmangur vonesat;

4. ndryshimi i mundshëm i datës së përfundimit të projektit;

5. ndryshime në personelin kryesor të PIU-ut, konsulentëve apo kontraktorëve;

6. arsyet që mund të ndikojnë në koston e projektit; dhe

7. ndonjë zhvillim apo aktivitet që ka të ngjarë të ndikojë në aspektin ekonomik të cilësdo pjesë të projektit.

ii) Një diagramë e tipit *bar-chart*, bazuar në kalendarin e zbatimit të projektit duhet të pranohet nga të dyja palët si nga Banka, ashtu dhe Huamarrësi në apo para datës së zbatimit të kontratës së punëve civile për pjesën A të projektit, duke treguar progresin në çdo pjesë të projektit, si dhe duke përfshirë një grafik të shpenzimeve të planifikuara, si dhe atyre aktuale;

iii) raportet financiare duhet të paraqesin detaje të shpenzimeve të realizuara nën secilën pjesë të projektit, si dhe tërheqjet nga huaja, së bashku me një deklaratë, ku tregohen:

1. llogaritjet origjinale të koston;

2. kostot e rishikuara, nëse ka të tilla, si dhe arsyet për këto ndryshime;

3. llogaritjet origjinale të shpenzimeve deri në datën e raportimit;

4. arsyet për devijimet e pikës (3) më lart nga shpenzimet aktuale; dhe

5. shpenzimet e llogaritura për tremujorët e mbetur të vitit; dhe

iv) një dokument i shkurtër mbi statusin e përputhshmërisë, me secilën nga angazhimet e bëra në Marrëveshjen e huasë.

c) Deri në pagesën e plotë apo anulimin e shumës së huasë, raportet lidhur me çështjet mjedisore të projektit referuar seksionit 4.04(a)(iii) të termave dhe kushteve standarde do të paraqiten në Bankë si raporte vjetore, më apo përpara datës 31 mars të çdo viti. Raporte të tilla do të përfshijnë çështje që kanë të bëjnë me shëndetin e punëtorëve, si dhe sigurinë e tyre lidhur me projektin, sikurse dhe elemente të tilla specifike si:

i) informacion mbi respektimin nga ana e Huamarrësit të rregullave dhe standardeve, lidhur me mjedisin të cilat pasurohen herë pas here në përputhje me juridiksionin në të cilin ndodhet projekti, si dhe me standardet ekzistuese të mjedisit në Bashkimin Europian në datën e këtushme, si dhe me dokumentin e Korporatës Ndërkombëtare Financiare “Politika të mbrojtjes së njerëzve autoktonë, strehimi i padëshiruar, si dhe pronësisë kulturore”, duke përfshirë dhe statusin e çfarëdo lejeje mjedisore të kërkuar për projektin, rezultatet e cilitdo inspektim të kryer nga autoritetet e mjedisit, ndonjë shkelje e rregullave dhe standardeve të tilla të mjedisit, si dhe masat përmirësuese të ndërmarra apo dhe gjopa të vëna në raste shkeljesh;

ii) informacion lidhur me zbatimin e planit të menaxhimit të mjedisit, duke përfshirë dhe ndonjë ndryshim të propozuar apo devijim në veprime, kalendar apo kosto;

iii) një përmbledhje të çfarëdo shënimi material, raporteve apo komunikimeve lidhur me çështjet e mjedisit, të paraqitura nga Huamarrësi përpara cilitdo autoriteti të mjedisit;

iv) informacion lidhur me shëndetin dhe sigurinë e projektit, duke përfshirë dhe shkallën e aksidenteve apo çdo iniciativë të lidhur me shëndetin dhe çështjet e sigurisë që janë zbatuar apo planifikuar nga Huamarrësi;

v) një përmbledhje të ndryshimeve në ligjet e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë, që mund të kenë një ndikim material mbi projektin;

vi) kopje të informacionit mbi mjedisin, të paraqitura në mënyrë periodike nga Huamarrësi pranë partnerëve apo në publik;

vii) një përmbledhëse mbi gjendjen e mjedisit dhe zbatimin e kërkesave mjedisore të projektit për t’u botuar në faqen e Bankës në internet; dhe

viii) çdo incident për mospërputhje me ligjet dhe rregulloret, duke përfshirë dhe ndonjë

veprim ligjor që përfshin Huamarrësin apo projektin.

d) Jo më vonë se 6 muaj nga data e përfundimit të projektit, Huamarrësi duhet t'i paraqesë Bankës një raport përfundimtar projekti lidhur me komponentët e projektit, raport që në formë dhe përmbajtje duhet të jetë i pranueshëm nga Banka.

e) Menjëherë me ndodhjen e ndonjë incidenti apo aksidenti të lidhur me projektin që ka të ngjarë të ketë dhe një efekt jo të favorshëm material mbi ambientin, shëndetin apo sigurinë, Huamarrësi duhet të njoftojë Bankën me anë të njoftimit me faks apo telex, duke specifikuar natyrën e një incidenti apo aksidenti të tillë, si dhe ndonjë hap të ndërmarrë nga Huamarrësi për rregullimin e situatës. Pa kufizuar përgjithësinë e kësaj, një incident ose një aksident ka të ngjarë që të shkaktojë një efekt material mbi mjedisin, shëndetin apo sigurinë, nëse çdo ligj i aplikueshëm kërkon njoftimin e një incidenti apo aksidenti të tillë, pranë cilitdo autoritet shtetëror, incidente apo aksidente të tillë, përfshijnë fatalitetet apo plagosje serioze që kërkojnë shtrim në spital, apo nëse një incident apo aksident i tillë është bërë publik si nëpërmjet medias, apo mjeteve të tjera.

f) Huamarrësi duhet të paraqesë pranë publikut të ndikuar, siç është përcaktuar në planin e konsultimit dhe hapjes me publikun, raporte vjetore lidhur me çështje që kanë të bëjnë me mjedisin, shëndetin dhe sigurinë.

Seksioni 3.05. Angazhimet lidhur me mjedisin

Pa kufizuar përgjithësimin e seksionit 4.02(a), 4.04 (a)(iii) dhe 5.02(c)(iii), të termave dhe kushteve standarde, si dhe seksionit 3.04(c) më lart, Huamarrësi:

a) duhet të realizojë projektin në përputhje me rregullat dhe standardet e mjedisit, të shëndetit dhe sigurisë, që ndryshojnë hera herës sipas juridiksionit të vendit ku ndodhet projekti, sipas Dokumentit të Korporatës Ndërkombëtare të Financës “Politika të mbrojtjes së njerëzve autoktonë, strehimi i padëshiruar, si dhe pronësisë kulturore”, nëse janë të zbatueshme, si dhe me standardet ekzistuese të BE-së mbi mjedisin, shëndetin dhe sigurinë. Huamarrësi duhet të bëjë vlerësimin e ndikimit të mjedisit për projektin në një vend të mundshëm me akses publik, në apo pranë kantierit të projektit;

b) duhet të vëzhgojë të gjitha ligjet e zbatueshme, si dhe standardet mbi punësimin, në veçanti ato të lidhura me punësimin e fëmijëve dhe të të rinjve, diskriminimin në punë, si dhe punën e detyruar. Ligjet dhe standardet e aplikueshme përfshijnë:

i) angazhimet përkatëse lidhur me Organizatën Ndërkombëtare të Punës, dhe

ii) ligjin vendas;

c) Pa kufizuar pjesën më lart, Huamarrësi duhet të zbatojë në mënyrë të kujdesshme dhe të përkrahë planin e menaxhimit të mjedisit;

d) Të sigurojë se punimet kryhen në përputhje me elementet e identifikuar gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis; dhe

e) Gjatë kryerjes së punimeve në përputhje me projektin, merren të gjitha masat e nevojshme për të garantuar se të gjitha kantieret e projektit janë menaxhuar në përputhje me praktikat e mira ndërkombëtare dhe se:

i) janë ndërmarrë hapa për menaxhimin e trafikut dhe minimizimin e shqetësimeve publike;

ii) janë marrë masa për të siguruar punëtorët dhe përdoruesit e rrugës;

iii) është minimizuar zhurma dhe ndërhyrjet; dhe

iv) se publiku është informuar në mënyrë adekuate lidhur me punimet e propozuara.

Seksioni 3.06 Njësia e zbatimit të projektit

a) Huamarrësi do të krijojë një njësi të zbatimit të projektit “PIU”, me qëllim që të koordinohen, menaxhohen, monitorohen dhe vlerësohen të gjitha aspektet e zbatimit të projektit, nën termat e referencës të pranueshme nga Banka, duke përfshirë dhe prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve të projektit.

b) Huamarrësi do të mbajë PIU-n gjatë të gjithë kohës së zbatimit të projektit dhe të krijojë mundësinë e operimit të PIU-t me të gjitha burimet e mjaftueshme, si dhe një personel të kualifikuar, nën termat e referencës të pranuar nga Banka.

Seksioni 3.07 Të dhënat dhe raportet financiare

a) Huamarrësi duhet të mbajë, në përputhje me departamentet apo agjencitë përgjegjëse të Huamarrësit për realizimin e projektit, të gjitha procedurat, të dhënat, si dhe llogaritë për të reflektuar, në përputhje me standardet e pranuar dhe për pasojë të zbatuara ndërkombëtare, operacionet, burimet dhe shpenzimet e lidhura me projektin, si dhe të monitorojë dhe reflektojë progresin e projektit (duke

përfshirë kostot e tij, si dhe përfitimet që krijohen prej tij).

b) Huamarrësi:

i) duhet të ketë të dhëna dhe llogaritë në përputhje me paragrafin (a) të këtij seksioni për çdo vit fiskal të audituar, në përputhje me parimet dhe standardet e pranuar dhe për pasojë të zbatuara në nivel ndërkombëtar, realizuar nga revizorë të pavarur të pranuar nga Banka;

ii) duhet të paraqesë pranë Bankës, sapo të ketë në dispozicion, por në çfarëdo rasti jo më vonë se gjashtë muaj nga mbarimi i çdo viti fiskal, raportin e një auditimi të tillë nga revizorët e caktuar për këtë qëllim, dhe ky raport duhet të jetë në detaje të tilla që t'i përgjigjet kërkesave të arsyeshme të Bankës; dhe

iii) duhet të paraqesë pranë Bankës informacione të tjera lidhur me të dhënat dhe llogaritë, sikurse dhe auditin, sa herë që kjo të kërkohej nga Banka.

Seksioni 3.08 Prokurimet

Për qëllime të seksionit 4.03 të termave dhe kushteve standarde, masa të tilla duhen zbatuar, me përjashtim të rasteve kur Banka nuk është dakord, të cilat do të drejtojnë prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe që do të financohen nga procedurat e huasë:

a) mallrat, punimet dhe shërbimet do të prokurohen me tender të hapur.

b) për qëllime të seksionit 3.08(a), në rastin e procedurave për tender të hapur, tenderin e përzgjedhur, tenderin e veçantë, si dhe blerjet e standardet për tender mbi bazën e konkurrencës brenda vendit, ato janë paraqitur në kapitullin 3 të rregullave të prokurimit të BERZH-it.

c) Të gjitha kontratat do të jenë subjekt i rishikimit të procedurave të paraqitura në aneksin 1 të rregullave të prokurimit të BERZH-it. Të gjitha kontratat do të jenë më parë subjekt rishikimi.

Seksioni 3.09 Konsulentët

a) Me qëllim që të mbështetet zbatimi i projektit, Huamarrësi duhet që, me përjashtim të rasteve kur Banka nuk është dakord, të punësojë apo të krijojë mundësi punësimi për konsulentë që do të mbikëqyrin zbatimin e punimeve civile nën pjesët A dhe B të projektit, siç është përshkruar në pjesën C të skedulit 1, si dhe të përdorë konsulentë kualifikimi, eksperiencë dhe termat e referencës së të cilëve janë të pranueshme nga Banka.

b) Huamarrësi duhet të paraqesë, pa tarifë, përpara çdo konsulenti të përfshirë në mbështetjen e elementeve të projektit apo në operacionet e Huamarrësit, të gjitha lehtësirat e nevojshme, si dhe mbështetjen e nevojshme për të realizuar funksionet e tyre, duke përfshirë këtu të gjitha dokumentet, materialet, si dhe çdo informacion tjetër që mund të lidhet me punën e tyre.

Neni 4

Ndërprerja, përshpejtimi, pezullimi

Seksioni 4.01 Ndërprerja

Elementet e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 7.01 (a)(xiv) të termave dhe kushteve standarde:

a) Kuadri legjislativ dhe rregullues i zbatueshëm në sektorin e rrugëve në territorin e Huamarrësit duhet të jetë i amenduar, i pezulluar, i shfuqizuar, i anuluar apo rregulluar, në mënyrë të tillë që të ndikojë materialisht dhe të mos favorizojë operacionet apo kushtet financiare të Huamarrësit apo aftësinë e tij për të realizuar projektin apo për të përmbushur çdo një nga detyrimet e tij të ndërmarra nën Marrëveshjen e huasë;

b) E drejta e Huamarrësit për të tërhequr huanë e BERZH-it apo fondet grant të BE-së do të pezullohet, anulohet apo ndërpritet, e tëra apo pjesërisht, në përputhje me termat e marrëveshjes relevante; megjithatë duhet pasur parasysh se kushtet e këtij paragrafi nuk do të gjejnë zbatim nëse Huamarrësi, me pëlqim të Bankës, krijon mundësinë e vënies në dispozicion se granteve apo huatë koncesionare të mjaftueshme për të krijuar fonde për realizimin e projektit, këto nëpërmjet burimeve të tjera nga Huamarrësi, në përputhje me termat dhe kushtet mbi detyrimet që ka Huamarrësi nën këtë Marrëveshje.

Seksioni 4.02 Përshpejtimi i maturitetit

Elementet e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 7.06(f) të termave dhe kushteve standarde:

a) Për çdo ngjarje e specifikuar në seksionin 4.01 që ka vazhduar për tridhjetë ditë pas njoftimit të dhënë nga Banka për Huamarrësin, me përcaktim nga ana e Bankës se kjo ngjarje ka

ndodhur, Banka paraqet vullnetin e saj për marrje masash në përputhje me kushtet e paraqitura në seksionin 7.06 të termave dhe kushteve standarde.

Neni 5 Efektshmëria

Seksioni 5.01 Kushtet e kërkuara për efektshmërinë

Elementet e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 9.02(c) të termave dhe kushteve standarde si kushte shtesë për vënien në efikasitet të kësaj Marrëveshjeje:

a) Banka ka marrë evidencë, në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Banka, se të gjitha të drejtat mbi huanë, të nevojshme për zbatimin e pjesëve A dhe B të projektit, janë përmbushur nga Huamarrësi dhe janë vënë në dispozicion të kontraktorit të punëve civile;

b) Banka ka marrë të dhëna, në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Banka, se kontributi vendas për të përmbushur projektin do të jetë i pranishëm apo është i përcaktuar në Buxhetin e Shtetit Shqiptar;

c) Plani Kombëtar i Transportit, në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Banka, do të jetë i përfunduar dhe i aprovuar nga Ministria e Transportit dhe do të jetë paraqitur pranë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për aprovim;

d) Banka ka marrë të dhëna, në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Banka, se e drejta e Huamarrësit për të marrë hua nga BERZH-i, për të bashkëfinancuar pjesët A dhe B të projektit, siç përshkruhet në skedulin 1, është bërë efektive;

e) Banka ka marrë të dhëna, në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Banka se ose:

i) e drejta e Huamarrësit për të marrë fonde grant nga BE-ja për supervizorin siç përshkruhet në pjesën C të skedulit 1 është bërë efektive; ose

ii) fonde të mjaftueshme janë vënë në dispozicion për Huamarrësin nga burime të tjera për të financuar supervizorin;

f) Huamarrësi dhe Banka duhet të kenë rënë dakord mbi planin e menaxhimit të mjedisit; dhe

g) Banka ka marrë të dhëna, në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Banka, mbi ratifikimin paraprak të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02 Kushtet e kërkuara për disbursimin e parë

a) Huamarrësi duhet të ketë krijuar njësinë e PIU-t, në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Banka, siç përshkruhet në seksionin 3.06 të kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) Banka ka marrë të dhëna se Huamarrësi ka hyrë në kontratë, në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Banka, për supervizionin e punimeve, siç përshkruhet në pjesën C të projektit në skedulin 1, me qëllim që të monitorohen të gjithë aspektet e zbatimit të punëve civile.

Seksioni 5.03 Opinionet ligjore

Për qëllime të seksionit 9.03 të termave dhe kushteve standarde, opinionin apo opinionet e avokatit do të jepen në emër të Huamarrësit nga Ministri i Drejtësisë.

Seksioni 5.03 Mbyllja apo dështimi për të arritur efektshërinë

Dita e 180-të pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje është specifikuar për qëllime të seksionit 9.04 të termave dhe kushteve standarde.

Neni 6 Të ndryshme

Seksioni 6.01 Njoftime

Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 10.01 të termave dhe kushteve standarde:

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bul. "Dëshmorët e Kombit", 1
Tiranë, Albania
Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Fax: (355) (4) 228 494

Për Bankën:
Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN, UK
Në vëmendje të: Njësisë Administrative të Operacioneve
Fax: +44-20-7338-6100
Telex: 8812161

Në prani të palëve, që veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, kjo Marrëveshje nënshkruhet në katër kopje në Londër, Angli, Tiranë, Shqipëri, në datën dhe vitin e shkruar në krye të Marrëveshjes.

LISTA 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i projektit është që të ndihmojë Huamarrësin në: (i) rehabilitimin dhe riparimin e një segmenti të llogaritur prej 70 km të rrugës me një kalim midis Fierit (Levan) dhe Tepelenës, që lidhet më tej me Greqinë, përgjatë një aksi rrugor kryesor veri – jug; (ii) përmirësimi i sektorit rrugor i financuar përmes përgatitjes dhe zbatimit të strategjisë për reformën e financimit të sektorit të rrugëve që merr në rishikim tarifat për përdoruesit e rrugëve, si dhe krijon mundësinë për një nivel të qëndrueshëm për rrugët shtetërore; (iii) përmirësimi i operacioneve, administrimit dhe menaxhimit të sektorit të rrugëve përmes përgatitjes së programit të ristrukturimit me një plan veprimi; dhe (v) rritja dhe përmirësimi i infrastrukturës së transportit përmes përplotësimit të një seksioni kyç të Korridorit Veri-Jug, që lidh territorin e Huamarrësit me Malin e Zi në Veri dhe Greqinë në Jug.

2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, subjekt i ndryshimeve të mundshme që mund të behën herë pas here me pëlqim dhe rënien dakord midis Bankës dhe Huamarrësit:

Pjesa A: Ndërtimi i segmentit të ri rrugor, llogaritur për 37 km, midis Fierit (Levan) dhe Dames.

Pjesa B: Përmirësimi i rrugës ekzistuese, llogaritur me 33 km, në seksionin midis Dames dhe Tepelenës.

Punimet për pjesët A dhe B më lart, me përjashtim të taksave, do të bashkëfinancohen me BEI-n. Huamarrësi do të financojë kompensimin e tokës, si dhe të gjitha taksat në përputhje me kontratën e punimeve civile.

Pjesa C: Supervizioni i punimeve për pjesët A dhe B

Një konsulent supervisor do të emërohet dhe do të ketë detyrën e monitorimit të zbatimit të punimeve nën pjesën A dhe B të projektit. Këto shërbime do të financohen nga BE-ja.

Projekti pritet të përfundojë në dhjetor 2008.

LISTA 2 KATEGORITË DHE TËRHEQJET

1. Tabela bashkëngjitur kësaj liste paraqet kategoritë, shumën e huasë së shpërndarë për secilën kategori, si dhe përqindjen e shpenzimeve për t'u financuar në çdo kategori.

2. Pavarësisht çfarë është përcaktuar në paragrafin 2 më lart, asnjë pagesë nuk do të bëhet lidhur me shpenzimet e ndodhura dhe të paguara para datës së Marrëveshjes së huasë.

Kategoria	Sasia e huasë së shpërndarë në monedhën e huasë	Përqindjet e shpenzimeve për t'u financuar
(1) Punimet në pjesët A& B	EUR 34,650,000	50 e vlerës së kontratës, duke përjashtuar taksat dhe detyrimet
(2) Komisioni përmbyllës	EUR 350,000	100% e komisionit përmbyllës
Totali	EUR 35,000,000	

LIGJ
Nr.9711, datë 12.4.2007

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË BULLGARISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT TË PALIGJSHËM DHE AKTEVE TË TJERA KRIMINALE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm dhe akteve të tjera kriminale”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5272, datë 23.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË BULLGARISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT TË PALIGJSHËM DHE AKTEVE TË TJERA KRIMINALE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë, në vijim të quajtura Palë Kontraktuese,

me qëllim që të kontribuojnë në kontaktet ndërmjet tyre;

të interesuar në vendosjen e bashkëpunimit për t’iu kundërvënë krimit, veçanërisht krimit të organizuar dhe krimit ndërkufitar;

duke synuar fuqizimin e përpjekjeve të tyre të ndërsjella për të luftuar terrorizmin ndërkombëtar;

të bindur për nevojën e koordinimit të aktivitetit të tyre kundër krimit të organizuar, krimit ndërkufitar, terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe aktiviteteve të tjera kriminale me pasoja ndërkombëtare;

në lidhje me legjislacionin ndërkombëtar dhe dispozitat e instrumenteve ligjore ndërkombëtare që vendosin detyrime për dyja shtetet,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

1. Lufta kundër terrorizmit:

- shkëmbimi i informacionit dhe rezultateve të përfthuara nga hetimet për akte terroriste të planifikuara ose të kryera kundër krerëve të shteteve, personave nën mbrojtje ndërkombëtare, përfaqësuesve të ambasadave dhe konsullatave, nëpunësve të organizatave ndërqeveritare, si edhe pjesëmarrësve në vizita në nivel shtetëror dhe ngjarje të tjera politike dhe sportive lokale ose ndërkombëtare;

- vëzhgimi i mënyrës së veprimit të kriminelëve, metodave të financimit të aktiviteteve të lartpërmendura, organizatave terroriste, planifikimit ose kryerjes respektivisht të krimeve kundër interesave madhore të secilës prej Palëve Kontraktuese.

2. Lufta kundër krimit të organizuar, zbulimi dhe hetimi i personave dhe organizatave, që lidhen me:

- trafikimin e paligjshëm, prodhimin dhe përdorimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope;

- trafikimin e paligjshëm të personave dhe shfrytëzimin e fëmijëve;

- trafikimin e paligjshëm të artikujve me përdorim të dyfishtë, materialeve bërthamore, pajisjeve dhe teknologjisë, armëve të zjarrit, municionit, substancave helmuese, eksplozivëve, si dhe pjesëve të tyre;

- krimet e lidhura me shfrytëzimin seksual;

- kontrabandën e gurëve të çmuar dhe metaleve të çmuara ose, gjithashtu, objekteve me vlera kulturore ose veprave të artit, që i përkasin pasurisë kulturore respektive kombëtare ose pasurisë kulturore ndërkombëtare;

- falsifikimin e dokumenteve, mjeteve monetare ose mjeteve të tjera të pagesës;

- kumarin e paligjshëm ose çdo lloj mashtrimi të përdorur në kumarin e ligjshëm;

- parandalimin, zbulimin dhe hetimin e makinave të vjedhura dhe trafikimit të tyre, si edhe krimet të cilat rezultojnë me shkelje të rregullave të trafikut rrugor;

- krimet kompjuterike dhe krimet kundër pronësisë intelektuale.

3. Lufta kundër korrupsionit, krimeve ndërkombëtare në ekonomi, si edhe kontrabandës, shmangies së pagesës së taksave, si edhe operacioneve fiskale dhe transaksioneve të tjera me para ose pronave që prezumohen se rrjedhin nga aktiviteti kriminal.

4. Lufta kundër migrimit të paligjshëm:

- lufta kundër migrimit të paligjshëm dhe kanaleve për trafikimin e personave;

- zbulimi i ofruesve të shërbimeve të transportit dhe agjencive turistike/të udhëtimit, të cilët marrin pjesë në aktivitetet që përfshijnë trafikun e personave;

- zbulimi i dokumenteve të udhëtimit të falsifikuara ose vizave të falsifikuara.

5. Palët Kontraktuese do t'i japin njëra-tjetrës asistencë në fushat e mëposhtme:

- organizimi dhe trajnimet e përbashkëta në lidhje me frenimin e krimit të organizuar dhe ndërkombëtar;

- organizimi dhe kontrolli i bazës së të dhënave që mbajnë kartat e identitetit;

- zhvillimi i metodave dhe sistemeve për përzgjedhjen, trajnimin dhe formimin profesional të ekspertëve nga të dyja Palët Kontraktuese, në fushat e përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 2

Format e bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve Kontraktuese do të kryhet me anë të:

1. shkëmbimit të informacionit në fushat sipas nenit 1, në lidhje me individë dhe grupe që marrin pjesë ose dyshohet se marrin pjesë në aktivitetet kriminale, të përshkruara në të njëjtin nen, veprimet e tyre, mënyrën e veprimit dhe objektivat e mundshëm të tyre, si edhe çdo çështje tjetër të rëndësisë operationale që provon domosdoshmërinë për parandalimin dhe kundërveprimin ndaj këtyre krimeve;

2. zbatimit të masave të caktuara ose operacioneve të caktuara, bazuar në miratimin e ndërsjellë të autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese;

3. shkëmbimit të ekspertëve në fushat e interesit të përbashkët;

4. shkëmbimit të dokumenteve, publikimeve dhe rezultateve të dala nga kërkimet shkencore në fushat me interes të përbashkët;

5. shkëmbimit të eksperiencës në lidhje me metodat dhe mënyrat e përdorura në parandalimin,

zbulimin dhe hetimin e aktiviteteve të lidhura me terrorizmin dhe aktet terroriste, krimin e organizuar ndërkombëtar, krimin ndërkufitar, si edhe aktivitete të tjera kriminale.

Neni 3 **Autoritetet kompetente**

1. Autoritetet kompetente, përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të jenë si më poshtë:

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ministria e Brendshme

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
BULLGARISË
Ministri i Brendshëm

2. Në mënyrë që të mbajnë një lidhje të shpejtë operacionale, autoritetet kompetente do të emërojnë një oficer si pikë kontakti, informacioni personal i të cilit (emri, mbiemri, pozicioni, numri i telefonit dhe numri i faksit) do të transmetohet nëpërmjet kanaleve diplomatike brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

3. Për aspektet praktike të zbatimit të neneve 1 dhe 2, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese mund të nënshkruajnë protokolle të veçanta për bashkëpunim, brenda kompetencës së tyre dhe në pajtim me legjislacionet kombëtare të shteteve.

Neni 4 **Shkëmbimi i informacionit**

Palët Kontraktuese do t'i japin njëra-tjetrës asistencë në përpunimin dhe analizën e informacionit, përsa i përket fushave referuar në nenin 1, dhe mund t'u japin autoriteteve kompetente të Palës tjetër Kontraktuese pajisje të posaçme dhe teknologji të posaçme, në përputhje me detyrimet e tyre ndërkombëtare në këtë fushë.

Neni 5 **Mbrojtja e të dhënave**

Në pajtim me legjislacionin kombëtar të Palëve Kontraktuese dhe me qëllimin e sigurimit të të dhënave, me karakter personal, të transmetuara, Palët do të respektojnë dispozitat e mëposhtme:

1. Pala Kontraktuese, e cila merr këto të dhëna, do t'i përdorë ato vetëm për qëllimet dhe nën kushtet e bëra të ditura nga Pala Kontraktuese, e cila jep të dhënat.

2. Me kërkesë të Palës Kontraktuese që jep të dhënat, Pala marrëse do të paraqesë informacion rreth mënyrës se si janë përdorur të dhënat dhe rezultatet e arritura.

3. Të dhënat e dërguara do t'u transmetohen vetëm organeve kompetente, përgjegjëse për luftën kundër krimit dhe të gjitha manifestimet e tij. Këto të dhëna duhet t'u transmetohen organeve të tjera vetëm pas një pranimi paraprak me shkrim nga Pala Kontraktuese që dërgon të dhënat.

4. Pala dërguese e të dhënave duhet të sigurojë që të dhënat e transmetuara janë të sakta, transferimi i tyre është i nevojshëm dhe i korrespondon qëllimit për të cilin ato janë dhënë. Nëse është zbuluar ose bërë e ditur se të dhënat e dërguara kanë qenë të pasakta, ose nuk duhej të ishin transmetuar, Pala marrëse do të bëjë menjëherë të gjitha përpjekjet e nevojshme për t'i korrigjuar të dhënat ose për t'i asgjësuar ato.

5. Me kërkesën e tij/saj, personi, të dhënat personale të të cilit janë transmetuar në pajtim me këtë Marrëveshje, do të informohet për përmbajtjen e këtyre të dhënave dhe përdorimin e tyre të qëllimshëm. Informacioni rreth përdorimit të të dhënave personale do të jepet në pajtim me legjislacionin kombëtar të shtetit të Palës dërguese.

6. Pala Kontraktuese, që jep të dhënat, deri në kohën e transferimit të tyre, përcakton afatin ligjor për asgjësimin e tyre, në pajtim me legjislacionin e saj kombëtar. Deri në fund të kësaj kohe, të gjitha të dhënat që i përkasin personit në fjalë, do të asgjësohen nëse nuk janë më tej të nevojshme për arritjen e qëllimit për të cilin u dhanë. Të gjithë të dhënat e marra do të eliminohen deri në datën e

pushimit të veprimit të kësaj Marrëveshjeje, Pala dërguese do të informohet rreth eliminimit të të dhënave dhe arsyeve për eliminimin e tyre.

7. Palët Kontraktuese do të jenë të detyruara të mbajnë procesverbale për të gjitha të dhënat e transmetuara, të marra dhe të eliminuara.

8. Palët Kontraktuese do të ofrojnë mbrojtje efektive për të gjitha të dhënat jopersonale, të shkëmbyera në bazë të kësaj Marrëveshjeje, me qëllim që të parandalojnë të drejtën e personave të paautorizuar për t'i njohur dhe përdorur këto të dhëna. Palët Kontraktuese nuk do të lejohen të ndryshojnë ose publikojnë këto të dhëna.

Neni 6 **Fshehtësia**

1. Palët Kontraktuese do të garantojnë fshehtësinë e çdo të dhëne, informacionit, materialeve ose pajisjeve, të shkëmbyera në kursin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me to, të cilat cilado nga Palët i sheh si të lidhura me subjektin, me kushtin që ata të kenë qenë të klasifikuara në pajtim me legjislacionin e Palës dërguese. Shkalla e mbrojtjes, përcaktuar nga Pala dërguese, nuk mund të ndryshohet.

2. Transferimi i materialeve, informacionit dhe pajisjeve teknike një Pale të tretë, në kuadrin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të kryhet vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim të autoritetit kompetent të Palës dërguese.

3. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë informacion të klasifikuar pas nënshkrimit të një marrëveshjeje të posaçme mbi shkëmbimin e përbashkët dhe mbrojtjen e përbashkët të informacionit të klasifikuar.

Neni 7 **Refuzimi i kërkesës për bashkëpunim**

1. Secila nga Palët Kontraktuese mund ta refuzojë tërësisht ose pjesërisht kërkesën për bashkëpunim/transferim të informacionit ose të lidhë zbatimin e saj me kushte të caktuara, sa herë që zbatimi i një kërkesë të tillë mund të cenonte sovranitetin dhe sigurinë kombëtare të Palës së kërkuar, ose të dhunonte legjislacionin e saj kombëtar ose detyrimet e tjera në kuadrin e traktateve ndërkombëtare.

2. Në këtë rast të veçantë, refuzimi ose kushtet e deklaruara për ekzekutimin e kësaj kërkesë do t'i komunikohet Palës tjetër Kontraktuese në afat të shkurtër.

Neni 8 **Komisioni i përbashkët**

1. Palët Kontraktuese do të krijojnë një komision të përbashkët me pesë përfaqësues për secilën Palë për të inkurajuar, vlerësuar dhe përmirësuar bashkëpunimin në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje. Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën rreth kandidatëve të tyre me anë të diplomacisë.

2. Takime vjetore të komisionit të përbashkët do të mbahen në mënyrë të njëpasnjëshme në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Bullgarisë. Secila nga Palët mund të propozojë nëse është e nevojshme që të organizohen takime plotësuese të komisionit.

Neni 9 **Shpenzimet**

Shpenzimet, që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të merren përsipër reciprokisht nga Palët Kontraktuese.

Neni 10

Marrëdhënia me palët e treta

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të cenojnë të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese, që e kanë burimin në traktatet e tjera dypalëshe ose shumëpalëshe.

Neni 11

Hyrja në fuqi dhe pushimi së vepruari

1. Kjo Marrëveshje do të lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar.
 2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 ditë nga data e marrjes së njoftimit të fundit, nëpërmjet të cilit Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën rreth përmbushjes së procedurave respektive kombëtare për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
 3. Kjo Marrëveshje mund të amendohet në çdo kohë me pëlqimin e të dyja Palëve Kontraktuese. Amendimet do të hyjnë në fuqi në pajtim me dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni.
 4. Çdonjëra nga Palët Kontraktuese mund t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje me anë të diplomacisë. Marrëveshja mund të konsiderohet se pushon së vepruari gjashtë muaj nga dita e marrjes së njoftimit respektiv nga Pala tjetër.
 5. Të gjitha mosmarrëveshjet dhe diferencat në interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të negocohen nga Palët Kontraktuese brenda komisionit të përbashkët dhe në rast dështimi, zgjidhja do të bëhet nëpërmjet diplomacisë.
- Firmosur në Tiranë, më 29.1.2007, në dy kopje origjinale, secila në shqip, bullgarisht dhe anglisht, duke qenë të gjitha njëllot të mirëfillta. Nëse shfaqen diferenca në interpretim, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 24.4.2007
Doli nga shtypi më 26.4.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
---------------------------	-------------------------

Shtypshkronja "Grafon"
Tiranë, 2007

Çmimi 36 lekë